

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5968
E hënë, 6 janar 2020
çmimi 0.40 €

PËR TË MOS I HARRUAR

FAQE 3

Shkruan:
Rexhep QOSJA



SOT (E HËNË) TAKOHEN PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI DHE LIDERI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI

FAQE 4-5



ÇËSHTJA E MANDATARIT BËN BASHKË THAÇIN DHE KURTIN

Tre muaj pas zgjedhjeve, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pritet ta marrë mandatin nga presidenti Hashim Thaçi për formimin e qeverisë së re pa marrëveshje politike me LDK-në. Pas disa përpjekjeve,

presidenti Thaçi dhe kreu i LV-së janë pajtuar që sot (e hënë) në orën 15:00 të takohen për t'u konsultuar zyrtarisht rreth mandatarit për formimin e qeverisë së re. Takimi Thaçi - Kurti është pritur me interes të madh nga

publiku jo pse do ta prodhojë mandatarin e ri të qeverisë, por për shkak të përplasjeve të mëdha që këto dy figura kanë pasur prej pasluftës. Deri më tani ata nuk kanë pasur asnjë takim formal mes vete

MIRATIMI I LIGJIT PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM TË POLICËVE DO TA RRISE MUNDËSINË PËR PUNËSIM TË GJENERATAVE TË REJA

Ka përfunduar draftligji për pensionimin e parakohshëm të policëve

Draftligji për pensionimin e parakohshëm të policëve ka përfunduar dhe është dërguar në Ministrinë e Financave por, si pasojë e dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, ky proces është ndalur. Drejtori i përgjithshëm i

Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nëse do të kalojë Ligji për pensionim të parakohshëm të policëve atëherë do të rekrutojnë njerëz të rinj për t'i zëvendësuar ata që pensionohen



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

NGJARJET NË MAL TË ZI ZHVESHIN QËLLIMIN E 'MINISHENIT' SERB F. 10

Shkruan: Bardhyl MAHMUTI



AKTUALE



DERI NË SHTATË ORË PRITJET NË MERDAR F. 6

IKSHPK-ja BËN THIRRJE PËR MARRJE TË VAKSINAVE F. 6

TAHIRI: SHBA-JA DHE BE-ja TË JENË NDËRMJETËSUERE NË PROCESIN E DIALOGUT ME SERBINË F. 5

EKONOMI

PRITJET E KOMUNITETIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2020 F. 9

'TREPÇA' PRET MILIONAT E PREMTUARA PËR RIMËKËMBJE F. 9



KULTURË

POEZITË E LULZIM TAFËS EDHE NË GJUHËN SLLOVENE F. 14

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

A po e humb Bashkimi Evropian ndikimin në Ballkan?

Me "lodhjen nga zgjerimi", BE-ja po humbet mjaft nga influenca e saj në rajonin e Ballkanit. Rusia, Kina apo Turqia duan t'i joshin këto vende, por a mundën ta zëvendësojnë ato BE-në?

BERLIN, 5 JANAR - Viti 2019 nuk ishte një vit i mbarë për njerëzit në periferinë e Bashkimit Evropian, në Evropën Juglindore. Ndryshe nga sa premtoi, BE-ja në samitin e tetorit nuk dha dritën jeshile për çeljen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Franca dolën kundër tyre, shkruan agjencia gjermane e lajmeve, dpa në një analizë për gjendjen në Ballkan me fillimin e këtij viti.

Rreziku i thyerjes së besimit

Në Serbi dhe Malin e Zi, dy vende që i kanë çelur ndërkohë negociatat, janë forcuar tendencat autoritare të forcave qeverisëse. Presioni ndaj intelektualëve dhe medie kritike është rritur. Gjendja në Shqipëri nuk është më e mirë, një vend ky jo shembull demokracie, shkruan dpa. Në nëntor Shqipëria u trondit nga një tërmet i rëndë me dhjetëra viktima. Por "Jo-ja" e bisedimeve të anëtarësimit ishte shumë e rëndë. Në Maqedoni kjo solli zgjedhje të parakohshme që do të mbahen më 12 prill.

Në rajonin e Ballkanit mosçelja e negociatave shihet si thyerje e besimit, si shprehje kërcënuese e "lodhjes nga zgjerimi" në vendet bazë të BE-së. Në një kohë që BE-ja kishte vendosur në samitin e saj në Selanik në vitin 2003, se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë perspektivën e anëtarësimit. Por deri më tani, kësaj ia ka dalë vetëm Kroacia, që u anë-



tarësua në vitin 2013. Për vendet e tjera të Ballkanit perspektiva po sfumohet në horizont, madje ato rrezikojnë ta humbasin atë, por a po rrezikon edhe vetë BE-ja humbjen e Ballkanit?

Tentativat ruse, kineze dhe turke

Alternativa të tjera, si Rusia, Kina apo Turqia janë në pritje. "BE-ja ka lënë një vakuum, të cilin Rusia e mbush me dëshirë", thekson Sonja Biserko, që drejton në Beograd Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. "Kina vjen nga ana tjetër me shumë para, që ofrohen në formë të kredive, pa standarde dhe pa kriterë", tha ajo.

Kurse Moska i jep mbështetje sidomos Serbisë, që nuk do ta

pranojë humbjen e Kosovës. Dihet, se Moska bllokoi veton e saj pranimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara. Kurse në Bosnjë e Hercegovinë, Rusia mbështet burrin e fortë të serbëve boshnjakë, Milorad Dodik. Në këtë vend të shkatërruar nga lufta në vitet 1992-1995, Dodiku paralizon zhvillimet me qëndrimet e tij separatiste. Pa harruar Malin e Zi, ku në tetor 2016, një puç i organizuar nga agjentë rusë, por i dështuar, do të duhej të pengonte anëtarësimin e vendit në NATO.

Qëllimi i Rusisë, është që të krijojë në Ballkan një "brez të vendeve neutrale nga ana ushtarake", ka thënë ambasadori rus në Shkup, siç duket edhe nga dokumente të brendshme të Ministrisë së Jashtme në Shkup nga viti 2017.

Por Moska nuk mundi ta ndalë anëtarësimin e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Serbia e përjashtoi anëtarësimin pas bombardimeve të vitit 1999. Në Bosnjë, Dodiku përpiqet të pengojë çdo afim me aleancën veriore-atlantike.

Kina nga ana e saj me strategjinë e "Rrugës së re të mëndafshit" ndjek interesa ekonomike me konceptin e saj ndërkontinental. Ballkani ka rolin e një zone transiti në këtë kontekst. Pekini ka arritur të marrë shumicën e aksioneve në portin e Pireut, dhe po modernizon hekurudhën mes Beogradit dhe Budapestit. Projektet financohen me kredi jo edhe aq të lira nga bankat shtetërore kineze. Firmat kineze i marrin në dorë ato, shpesh edhe me punëtorë "të importuar" nga Kina. Bilanci i

krijimit të vlerës për këto vende kredimarrëse është i dobët. Mali i Zi rrezikon për shkak të një autostrade të financuar nga Kina të futet në borxhe të rrezikshme.

Edhe Turqia me presidentin e saj autokrat, Recep Tayyip Erdogan kërkon afrimin me aktorët e politikës myslimane, por jo vetëm me ta. Partia, SDA që kontrollon kryesisht pjesën boshnjake-myslimane e nderon Erdoganin si fatsjellës. Por edhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq ka marrëdhënie të mira me Erdoganin. Interesat e Erdoganit janë kryesisht ekonomike- një treg për mallrat turke. Nga ana tjetër ai kërkon të risë edhe influencën gjeopolitike.

Vërtet po e bëjnë për vete Ballkanin Rusia, Kina dhe Turqia?

"Sigurisht entuziazmi në rajon për BE-në po ftohet dukshëm", thotë Florian Bieber, profesor në Institutin e Evropës Juglindore në universitetin e Gracit. "Por duhet thënë edhe tjetra, se aktorë të jashtëm si Rusia e Kina nuk kanë shumë për të ofruar. Elitat shpesh të korruptuara dhe autoritare të Ballkanit do t'i pranoni projektet e tyre me dëshirë, jo vetëm që të pasurohen me to", tha ai. "Por po të shikosh investimet e tyre, krahasuar me ato të BE-së atëherë ato nuk e kanë atë rëndësi", thekson politologu, Florian Bieber për dpa. Bieber përmend edhe një faktor tjetër për të theksuar rëndësinë e BE-së. Mjafton të pyesësh të rinjtë në Ballkan, se ku do donin të jetonin, thotë ai. "Ata nuk do të përmendin Pekinin, Stambollin apo Shën Petersburgun, por Berlinin ose Vjenën", tha Bieber. (dw).

Zoran Milanović, president i ri i Kroacisë

ZAGREB, 5 JANAR - Kandidati për president të Kroacisë, Zoran Milanović, sipas exit pollit, mori 53,25% të votave, kurse Kolinda Grabar Kitarović mori 46,75%, ka njoftuar Radiotelevizioni i Kroacisë. Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović, e partisë konservatore Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) dhe ish-kryeministri Zoran Milanović i Partisë Social Demokratike (SDP) të dielën garuan në balotazhin e zgjed-

hjeve presidenciale.

Në raundin e parë të zgjedhjeve dy javë më parë, Milanović fitoi ndaj 11 kandidatëve të tjerë, duke marrë 29.6 për qind të votave. Ai doli para presidentes në detyrë, Kolinda Grabar-Kitarović, cila mori 26.7 për qind të votave.

Roli i presidentit është kryesisht ceremonial në Kroaci. Presidenti nuk mund t'i vë veton ligjeve, por është komandant i ushtrisë dhe përfaqëson vendin në arenën ndërkombëtare.




Kroacia, e cila mori presidencën e radhës të Bashkimit Evropian më 1 janar 2020, do t'i mbajë zgjedhjet e ardhshme parlamentare në vjeshtë.

Milanović, i cili ishte kryeministër i vendit nga vitin 2011 deri në vitin 2015, zhvilloi fushatën e tij zgjedhore me premtimin se ai do të luftonte korrupsionin që ai thotë se ishte intensifikuar që kur ai humbi pushtetin dhe konservatorët morën drejtimin e vendit.

PËR TË MOS I HARRUAR

SHKRUAN: REXHEP QOSJA



ANTOLOGJIA E TË PËRZGJEDHURVE

1. Dy ditët e para të këtij viti disa nga TV-të tona bënë antologjinë e figurave dhe ngjarjeve, të bërave dhe veprimeve më të rëndësishme të 12 muajve të vitit që shkoi. Në këtë antologji u panë vetëm njerëz politikë dhe vetëm ngjarje, veprime e të bëra politike.

Asnjë intelektual, asnjë shkencëtar, asnjë albanolog, asnjë shkrimtar, asnjë artist, asnjë regjisor, asnjë kompozitor dhe, rrjedhimisht, asnjë roman, asnjë dramë, asnjë ekspozitë artesh pamore, asnjë film, asnjë shfaqje teatrore.

Kosova e kësaj antologjie ishte shkretëtirë. Mendova: Kosova është e kapur prej aleancës politike-media, mendjerrdhur, e korruptuar, egoiste, e pandërgjegje, e papërgjegjshme, cenuese për kulturën, për qytetërimin, për identitetin, për të sotmen e për të ardhmen e Kosovës!

KONCEPTI POLITIK I SHPËTIMIT

2. Gati të gjitha mediet tona e dhanë deklaratën e kryeministrit në detyrë Ramush Haradinaj, në të cilën u tha se "koncepti politik i Albin Kurtit është mashtrim". Mendova: si mund të jetë

mashtim ai koncept politik, i cili, në vend se shtet të privatizuar, në vend se shtet të milionerëve politikë, të pasuruar në sajë të posteve politike, në vend se shtet në të cilën zhatjet, mashtrimet, plaçkitjet, uzurpimet, nepotizmat, korrupsionet janë bërë sistem, Kosovën do ta bënte shtet të së drejtës sociale, shtet në të cilin do të harmonizoheshin ato që quajmë kombëtare dhe ato që quajmë qytetare, shtet me sistem të vlerave, shtet në të cilin vendi i parë i dhurohet qytetarit e jo partiakut, shtet i së drejtës me institucione të stabilizuara, në të cilat, në vend të sundimit personal, vepron qeverisja institucionale. Kur Kosova e Shqipëria të bëhen shtete të këtilla nuk do të vuajnë prej krizave prej të cilave po vuajnë aq shpesh e aq shumë. Koncepti që kryeministri në detyrë e quan koncept i mashtrimit në të vërtetë është koncept i shpëtimit të shtetit të Kosovës dhe të demokracisë së saj.

DIPLOMACIA JONË

3. Mjaft organizata joqeveritare dhe shumë qytetarë po vajojnë për gjendjen në Ministrinë e Jashtme të Kosovës prejse është formuar ajo. Pse të mos e vajojnë kur numri më i madh i atyre që i përbëjnë ambasadat e konsullatat tona në botë janë anëtarë partish, kur një numër i madh i tyre janë farefis më të afërt a më të largët të zyrtarëve të lartë, të milionerëve politikë dhe, këta që e ankojnë e

vajojnë këtë gjendje në këtë Ministri shtrojnë pyetjen: a mund të jetë e suksesshme politika jonë e jashtme kur kriteri i përzgjedhjes së diplomatëve të saj nuk është përgatitja e aftësia profesionale, dija e kultura e përgjithshme, përvoja politike e njohja e vendeve në të cilat do të shërbejnë, por lidhjet e tyre të ndryshme të nënlojshme e të mbillojshme partiakësie e farefisnie, regjionale e personale, interesi dhe borxhlarjeje me zyrtarët e lartë! Përgjigjja dihet.

KRYETARI I ARDHSHËM I KOSOVËS

4. Posti i kryetarit të ardhshëm të Kosovës, që do zgjidhet në vitin 2021, është bërë shkak kryesor, mos i vetmi, që dy partitë që i kanë nisur bisedimet për krijimin e koalicionit nuk po arrijnë ta krijojnë atë koalicion dhe nuk po arrijnë t'i krijojnë institucionet shtetërore. Partia që doli e dyta në zgjedhje, LDK-ja, edhe pse e dyta, kërkon të jetë jo e barabartë, por e privilegjuar në institucionet që do të krijohen! Përpos pesë ministrive sa do të ketë edhe partia e parë që i ka fituar zgjedhjet, VV, dhe postit të kryetari të Kuvendit, kërkon të ketë edhe postin e kryetarit të Kosovës! Është kjo një çudi e çudirave! Je parti e dytë, d.m.th. parti që s'i ke fituar zgjedhjet për ta krijuar qeverinë e kërkon të jesh në institucionet shtetërore parti me dy

postet më të larta, me postin e kryetarit të Kuvendit dhe me postin e kryetarit të shtetit! Ku ndodh kjo?!

Kryetari i LDK-së që për shumë vështrues të punëve tona politike lë përshtypjen e uzurpuesit të LDK-së sot, po e dëshiron edhe postin e kryetarit të Kosovës: ende s'dihet sigurt për veten apo për ndonjë anëtar tjetër të kësaj partie.

Fajtorin e moskrijimit të qeverisë së Republikës së Kosovës sot, mos ta kërkojmë, prandaj, andej e këndeje, po aty ku është: e është në politikën e kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa. Dhe, të atyre të tjerëve jashtë LDK-së, që duan ta pengojnë Vetëvendosjen që të bëhet forca politike historike, që do realizojë vullnetin e popullit për ndryshimin e gjendjes që po e gulçon Kosovën, që moçalishten shtetërore të Kosovës të vërshuar prej korrupsionit, nepotizmit, kriminit të organizuar, padrejtësive, përpjekjeve për të gjetur shpëtim në botë rinia e saj, despotizmit primitiv don ta shërojë e ta bëjë shtet të shëndoshë, modern, demokrati, të denjë për të jetuar i lirë e i denjë në të.

POLITIKA DHE SHKENCA

5. Pak para Vitit të Ri, kryetari i Shqipërisë, Ilir Meta, deklaroi: është koha për të dëgjuar shkencëtarët, e jo servilët. Është kjo deklaratë që s'është

dëgjuar ndonjëherë në politikën shqiptare gjatë 30 vjetëve të fundit.

Është kjo një deklaratë historike shumë, shumë e vonuar, por më mirë edhe e vonuar sesa e harruar përgjithmonë.

Politikanët shqiptarë në përgjithësi mbështeten në shumë vende, në shumë kënd, në shumë çka, në të mira e në të këqija, por në shkencën sikur s'kanë pasur jo vetëm qejf të mbështeten, por as nuk iu ka shkuar mendja për të bërë këtë!

Shqipëria është shtet me traditë e përvojë shtetërore e Kosova është shtet i ri pa atë traditë e pa këtë përvojë, por asnjëra, as Shqipëria e as Kosova, s'e duan përfshirjen e shkencëtarëve e njerëzve të dijes në politikë dhe s'i shohin as të nevojshme e as të dobishme të dhënat shkencore për politikëbërje. Për këtë arsye vendimet politike, rezultatet politike, ndodh shpesh të na sjellin pengesa e pendesa, dëmtime e zhgënjime. Deri kur?!

Meqenëse këto pesë tema i paraqita shkurt, me nga disa fjali, kësaj të fundit po ia shtoj edhe një fjali të autorit Zhan Daniel Ruh: duhet të bashkohet bota e shkencës me miratimin e vendimeve politike.

Në qoftë se vendimet politike nuk bazohen në të dhëna të arritura me dije, në hulumtime të sakta shkencore, vlefshmëria e tyre shumë shpesh është afatshkurtër, kurse më shpesh ndodh të bëhen vendime politike dëmsjellëse, dëshpëruese.

Siç edhe po ndodh!

Sot (e hënë) takohen presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti

Çështja e mandatarit bën

Tre muaj pas zgjedhjeve, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pritet ta marrë mandatin nga presidenti Hashim Thaçi për formimin e qeverisë së re pa marrëveshje politike me LDK-në. Pas disa përpjekjeve, presidenti Thaçi dhe kreu i LV-së janë pajtuar që sot (e hënë) në orën 15:00 të takohen për t'u konsultuar zyrtarisht rreth mandatarit për formimin e qeverisë së re. Takimi Thaçi - Kurti është pritur me interes të madh nga publiku jo pse do të prodhojë mandatarin e ri të qeverisë, por për shkak të përplasjeve të mëdha që këto dy figura kanë pasur prej pasluftës. Deri më tani ata nuk kanë pasur asnjë takim formal mes vete



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 JANAR - Sot (e hënë) në Presidencën e Kosovës pritët të takohen dy kundërshtarët më të mëdhenj politikë në 20 vjetët e fundit. Pas disa përpjekjeve, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, janë pajtuar që sot (e hënë) në orën 15:00 të takohen për t'u konsultuar zyrtarisht rreth mandatarit për formimin e qeverisë së re.

Lideri i LV-së, si fitues i zgjedhjeve të 6 tetorit, pritët të mandatohet për kryeministër nga shefi i shtetit pa marrëveshje politike me LDK-në, të cilën LV-ja e sheh si partnere të vetme për ta formuar qeverinë pas zgjedhjeve të 6 tetorit.

Takimi i parë Thaçi - Kurti do të ndodhë pasi lideri i LV-së refuzoi tri herë me radhë ftesën e presidentit Hashim Thaçi për takim konsultativ. Më në fund, Kurti ka propozuar 6 janarin si datë për takim, për të cilën është pajtuar edhe presidenti Thaçi, duke caktuar orën e takimit.

Takimi mes presidentit dhe pretendentit për kryeministër po shihet si një ngjarje e jashtëzakonshme, meqenëse Thaçi dhe Kurti nuk kanë pasur ndonjë takim formal deri më tani. Prej vitesh këto figura kanë hedhur akuza prej më të ndryshmeve kundrejt njëri-tjetrit.

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se takimi i parë Thaçi - Kurti do të ishte normal, por për shkak të raporteve të tyre po shihet si një ngjarje e madhe.

Analisti politik Imer Mushkolaj ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se ky takim do të duhej të ishte vetëm procedurë kushtetuese. "Një takim që do të duhej konsideruar normal, ndërmjet një presidenti të

shtetit dhe një mandatarit për kryeministër, për shkak të raporteve të acaruara po shihet si një ngjarje e madhe. Ndërkaq do të duhej të ishte veç një zhvillim kushtetues", ka thënë ai.

Edhe analisti tjetër politik, Faton Abdullahu, ka thënë për "Epokën e re" se ky takim do të jetë lajm i madh sepse do të takohen dy figura që përfaqësojnë dallime të mëdha. "Takimi i presidentit Thaçi dhe kandidatit të mundshëm për kryeministër, z. Kurti, është lajm i madh. Është kështu jo pse sot do ta prodhojë mandatarin e ri të qeverisë, por pse bëhet takimi ndërmjet dy figurave që përfaqësojnë dallime të mëdha dhe konfliktuoze jo vetëm politike. Është takim i rëndësishëm, mbase spektakël politik, nëse vështrrohet nga prizmi i ngjarjeve të kaluara, por mund të jetë krejt i parëndësishëm, mbase i dështuar, nëse shihet nga perspektiva e krijimit të qeverisë", ka thënë Abdullahu.

Pas mandatimit nga presidenti, sipas Kushtetutës së Kosovës, Kurti ka kohë që brenda 15 ditësh ta formojë qeverinë e re.

LV-ja dhe LDK-ja, edhe tre muaj pas zgjedhjeve, pa marrëveshje për bashkëqeverisje

Ndonëse kishin premtuar marrëveshje të shpejtë, Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, si subjekti i dytë në këto zgjedhje, nuk kanë arritur një marrëveshje për formimin e qeverisë së re. Bisedimet mes këtyre dy subjekteve politike janë përkeqësuar më 26 dhjetor, kur në seancën konstituive të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës, LV-ja, pa konsultim paraprak me LDK-në, ka propozuar për

kryetar të Kuvendit deputetin Glauk Konjufca, i cili edhe u zgjodh me 75 vota për, 27 kundër dhe 6 abstenime.

Pas këtij veprimi të njëanshëm të LV-së, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka deklaruar se gjithçka do të nisë prej fillimit dhe duhen negociata të reja për ndarjen e përgjegjësisë.

Njohësit e rrethanave politike kanë shprehur optimizëm se më në fund mund të ketë një marrëveshje në mes këtyre dy subjekteve politike. Analisti politik Imer Mushkolaj ka vlerësuar se e rrugës do të ishte që takimi Thaçi - Kurti t'i zinte LV-në dhe LDK-në me marrëveshje për bashkëqeverisje. "Do të ishte e udhës që LV-ja dhe LDK-ja ta

kishin të nënshkruar marrëveshjen dhe qeveria të krijohet shpejt. Por, pavarësisht kësaj, po qe se dy partitë kanë vullnet për koalicion, ka kohë të mjaftueshme për ta arritur atë. Mbetet të shihen cilat do të jenë kërkesat e LDK-së dhe oferta e LV-së tash, pas situatës së krijuar me zgjedhjen e kryeparlamentarit", është shprehur Mushkolaj.

Ndërsa analisti tjetër Faton Abdullahu ka thënë se LV-ja nuk mund të bëjë asnjë hap politik para pa LDK-në. "Por qytetarëve më shumë se kaq u intereson e ardhmja. Z. Kurti nuk i ka faj Thaçi për asgjë në procesin e vonuar të themelimit të qeverisë. Kurti fajtorin duhet ta

kërkojë në llogaritë me moral të pakët politik që i bën me LDK-në. Ai ende nuk po e kupton, në atë që do të duhej të bindet, se dita e LV-së nuk vjen dhe ai nuk mund ta bëjë asnjë hap politik para, as tash, as në të ardhmen, pa LDK-në. Sado që kjo mund t'i duket tradhti për parimet e tij ëndërrimtare, nëse nuk e pranon këtë realitet, Kurti duhet të largohet dhe t'u lëshojë rend kombinimeve të tjera", ka thënë ai.

Abdullahu ka deklaruar se krijimi i qeverisë nuk varet nga Thaçi e as nga veprimet e tij. "Ai po mban qëndrim korrekt në krejt këtë proces, pajustifikueshëm të prolonguar. Krijimi i qeverisë varet nga mar-

bashkë Thaçin dhe Kurtin



rëveshja LV - LDK. Mosmarrëveshja LV - LDK është marrëzi politike, papërgjegjësi shtetndërtuese dhe kombëtare që po e dëmton dhe dobëson me shpejtësi marramendëse vendin tonë dhe demokracinë e brishtë që kemi. Kjo duhet të ndalet. Nëse marrëveshja nuk ndodhë brenda afatit, z. Thaçi duhet të veprojë pa hamendësim që mosmarrëveshjen LV - LDK ta ndalë në interes të Kosovës dhe kualitetit të jetës së qytetarëve të vendit tonë", është shprehur ai.

Edhe subjektet politike që janë pajtuar se këtë mandat do të jenë opozitë, e kanë ftuar LV-në dhe LDK-në që ta formojnë sa më shpejt qeverinë e re.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë për "Epokën e re" se nuk ka pritur që formimi i institucioneve do të marrë kaq shumë kohë. "Kur kam dhënë dorëheqje në fund të korrikut kam pritur se pas dy apo tre muajve nuk do të vij më në këtë zyrë. Pra, kam pritur se pas zgjedhjeve do të krijohen institucionet e vendit. Pas zgjedhjeve të suksesshme kam pritur se procesi i konstituimit të institucioneve të ndodhë më shpejt", është shprehur Haradinaj.

Kurse zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë për gazetën se vendi ka hyrë në krizë politike për shkak të këtyre dy subjekteve politike. "Të

enjten është bërë një hap i rëndësishëm i konstituimit të Kuvendit të Kosovës, të zbatimit të Kushtetutës dhe marrjes së mandatit nga qytetarët nga ana e Kuvendit të Kosovës. Mendoj se politikisht vendi është në krizë meqë duket se nuk ka besim dhe vullnet mes partnerëve të cilët do të duhej ta formojnë koalicionin qeverisës dhe si të lëvizet përpara. Do të thotë, e kam përshtypjen se vendi është në një lloj krize politike", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se LV-ja dhe LDK-ja nuk janë afër marrëveshjes. "Partnerët e koalicionit nuk janë afër që të merren vesh për përbërjen e qeverisë dhe po shohim hapa të njëanshëm të

një subjekti politik dhe deklarime shumë kundërthënëse të një subjekti tjetër politik, që tregon se është një situatë e paqartë dhe më e komplikuar sesa e kanë pritur qytetarët e Kosovës. Të dy partitë kanë deklaruar publikisht se do të bëjnë koalicion

paszgjedhor dhe u takon këtyre dy partive që t'u tregojnë qytetarëve se cilat janë problemet për mosunitetin e tyre politik", është shprehur Hoxhaj. Në zgjedhjet e 6 tetorit Lëvizja Vetëvendosje doli e para me 29 deputetë, e pasuar nga LDK-ja me 28 deputetë.

Tahiri: ShBA-ja dhe BE-ja të jenë ndërmjetësuese në procesin e dialogut me Serbinë

PRISHTINE, 5 JANAR - Marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë paqësore, në kufijtë ekzistues, e ku duhet të përshihen edhe reparacionet e luftës dhe suksesionet. Kështu ka thënë në një intervistë për "Ekonomia Online" ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri. "Dialogu duhet të shkojë drejt një marrëveshje paqësore të qëndrueshme. Duhet të bazohen në njohjen reciproke në mes të dy shteteve në kufijtë ekzistues që do të marrë parasysh reparacionet e luftës dhe suksesionet. Nën rekrecionet duhet të ketë garanci, e garanci është njohja reciproke që siguron që nuk rikthehen arsyet e konfliktit dhe vendoset një paqe afatgjatë dhe e qëndrueshme në mes të dy shteteve si një kontribut edhe për të ardhmen, jo vetëm të dy shteteve që synojnë ardhmëri evropiane, por edhe për Ballkanin", ka thënë ajo.

Tahiri ka pohuar se Kosova në marrëveshjen përfundimtare duhet të kërkojë edhe 1/8 e pasurisë së ish-Jugosllavisë pasi ka qenë pjesë federale e saj. "Kosova në këtë dialog duhet të kërkojë 1/8 e pasurisë së ish-Jugosllavisë sepse lindja e shtetit të Kosovës është prej arsyeve kryesore zhbërja e ish-Jugosllavisë, ku kanë qenë 8 njësi federale. Kosova ka qenë një prej tyre dhe i takon 1/8 e pasurisë. Këto janë parimet

kryesore që kishin rezultuar në një marrëveshje paqe të qëndrueshme dhe e kishin mbyllur kapitullin e armiqësive jo vetëm në mes të Kosovës dhe Serbisë, por edhe në mes të dy kombeve: shqiptarëve dhe serbëve", ka deklaruar Tahiri.

Ajo ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) duhet të jenë ndërmjetësues në dialog që ky proces të përmbillet. "Edhe ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian duhet të jenë ndërmjetësues të këtij dialogu. Ne si qeveri në vitin 2014 e kemi dorëzuar platformën për fazën finale për një marrëveshje paqësore ku kërkojmë decidivisht që të dyja duhet të jenë pjesë e dialogut", është shprehur ajo.

Ish-udhëheqësja e dialogut teknik është shprehur se presidenti nuk ka autorizim për ta udhëhequr dialogun me Serbinë dhe se qeveria Haradinaj ka shkelur Kushtetutën pasi nuk e zbatoi të drejtën për ta udhëhequr atë. "Presidenti nuk ka autorizime për dialogun, Kuvendi i Kosovës e ka autorizuar qeverinë që ta udhëheqë dialogun. Tani që kjo qeveri që po shkon nuk e zbatoi këtë të drejtë dhe e shkeli Kushtetutën është çështje që duhet ta bisedonim me ta. Është sërish Kuvendi i Kosovës ai që duhet ta autorizojë delegacionin e Republikës së Kosovës për dialog", ka thënë Tahiri.



Në tetëvjetorin e vdekjes përkujtohet Shaban Shala

PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - "Para tetë vjetëve vdiq një nga komandantët më të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Shaban Shala, që tërë jetën ia kushtoi idealit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Shaban Shala mbetet figurë e ndritur e historisë së re të Kosovës", kështu e ka përkujtuar të dielën presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ish-komandantin e UÇK-së, Shaban Shala. Ndërkaq kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Shaban Shala ishte personazh i epokave më të ndritura të historisë së Kosovës. "Para luftës ishte në organizimet atdhetare që i paraprinë themelimit të UÇK-së, ndërsa në luftë u shqua si organizator dhe prijës i saj. I ndershëm, besnik dhe patriot i vërtetë, do ta vazhdonte kontributin për ndërtimin e ven-

dit, me theks të veçantë themelimin dhe zhvillimin e TMK-së dhe të FSK-së. Tetë vjet më parë ai iu bashkua të vëllait dëshmor, Bedriut, e shumë bashkëluftëtarëve të tjerë, duke lënë zbrazëtirë të madhe në proceset shtetndërtuese, por duke mbetur përgjithmonë në kujtesën historike. Lum Atdheu që kishte burra si ai", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Shaban Shalën e ka përkujtuar edhe ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Xhavit Haliti. "Para tetë vjetësh Kosova humbi një nga bijtë më të përkushtuar për liri dhe pavarësi, gjeneralin e UÇK-së, Shaban Shala. Shala ishte burrë i fortë, atdhetar i pashoq dhe luftëtar i zoti", ka shkruar Haliti në llogarinë e vet në "Facebook".



Lirohen nga akuza të përfshirët në rastin 'Pronto'



PRISHTINË, 5 JANAR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar nga akuza të gjithë personat e përfshirë në rastin e njohur si 'Pronto', në të cilin protagonistin kryesor ishte ish-shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Adem Grabovci. Në aktakuzë, përveç Grabovcit, kanë qenë të përfshirë edhe ish-ministri i Inovacionit, Besim Beqaj, dhe ish-deputeti nga Partia Demokratike e Kosovës, Zenun Pajaziti. Gjithashtu, si të akuzuar përmenden edhe ish-sekretarë të përgjithshëm të ministrive, një ish-zëvendësministër, këshilltarë politikë, drejtorë të ndërmarrjeve publike dhe zyr-

tarë nga pushteti lokal. Në muajin prill të vitit 2018 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ngritur aktakuzë për këtë rast. Në aktakuzë është trajtuar çështja penale e punësimeve dhe ndarjes së posteve të bazuara në përkatësi partiake dhe raporte personale. Ngritja e aktakuzës kishte pasuar publikimin në mediat lokale të bisedave telefonike të vitit 2011, të ish-shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në të cilat qenë përfshirë, veç të tjerash, edhe presidenti aktual Hashim Thaçi dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.

Deri në shtatë orë pritjet në Merdar



PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - Kolonat e gjata janë duke vazhduar në pikat kufitare në Merdar dhe te Dheu i Bardhë. Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar ka njoftuar se për të dalë nga Kosova në pikën kufitare të Merdares duhet të prisni deri në shtatë orë. Situata më e lehtë duket të

jetë te Dheu i Bardhë, ku për të dalë nga Kosova duhet të prisni deri në një orë, ndërsa në Jarinje deri në dy orë. Ndërsa për të hyrë në Kosovë në Merdar dhe te Dheu i Bardhë pritjet janë deri në 10 minuta, ndërsa te pika kufitare në Jarinje për të hyrë në Kosovë duhet të prisni 5 minuta.

IKShPK-ja bën thirrje për marrje të vaksinave

PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë apel te qytetarët që të vaksinohen pasi që virusi A i

gripit është përhapur edhe në Kosovë. "Qytetarë të nderuar, virusi A i gripit është në qarkullim në Kosovë, andaj rekomandohet të vaksinohen personat e

ndjeshëm, në radhë të parë personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit. Mbani higjienën personale, lani duart sa më shpesh, ajrosni mjediset

e mbyllura dhe mos rrini në vendet ku grumbullohen shumë njerëz dhe mos dilni kur ajri është i papastër!", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.



Miratimi i Ligjit për pensionimin e parakohshëm të policëve
do ta rritë mundësinë për punësim të gjeneratave të reja

Ka përfunduar draftligji për pensionimin e parakohshëm të policëve

Draftligji për pensionimin e parakohshëm të policëve ka përfunduar dhe është dërguar në Ministrinë e Financave por, si pasojë e dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, ky proces është ndalur. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nëse do të kalojë Ligji për pensionim të parakohshëm të policëve, atëherë do të rekrutojnë njerëz të rinj për t'i zëvendësuar ata që pensionohen

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 JANAR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se Policia e Kosovës vitin 2019 e ka përmbyllur suksesshëm, duke u bazuar në faktin e rezultateve të mira që ka pasur. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", Qalaj ka thënë se 2019-ta ka qenë një vit me shumë sfida, me shumë ngarresa dhe aktivitete, por që rezultatet tregojnë se ka pasur një trend të zvogëlimit të krimeve të të gjitha llojeve dhe kjo është baza e suksesit të Policisë së Kosovës. Ai ka thënë se krahas sukseseve që kanë pasur në vitin që lamë pas, nuk kanë arritur ta

shtojnë ende çështjen e pensionimit të policëve që ka qenë edhe premtim që nga fillimi i mandatit të tij si drejtor i përgjithshëm i policisë. Po ashtu, Qalaj ka thënë nuk kanë arritur të shtojnë përpara edhe çështjen e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për policët. "Sa i përket Ligjit për pensionim të parakohshëm, në fakt draftligji ka përfunduar dhe e kemi dërguar në Ministrinë e Financave por, si pasojë e dorëheqjes së kryeministrit, procesi u ndal. Një nga sukseset e mëdha ka qenë edhe dërgimi në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri të dy gjeneratave, njëra që ka diplomuar dhe gjenerata e dytë që po vazhdon trajnimin. Kemi pasur gjeneratat më të

mëdha për nga numri që nga themelimi i Policisë së Kosovës. Mund të them lirisht se janë edhe gjeneratat më të përgatitura qoftë nga aspekti profesional dhe ai fizik. Besoj se diku nga muaji qershor në këtë vit do ta dërgojmë edhe gjeneratën tjetër, meqenëse i kemi vendet e

zbrazura në Policinë e Kosovës që ta dërgojmë edhe gjeneratën e re. Nëse kemi fat që të kalojë Ligji për pensionim të parakohshëm normalisht do të rekrutojmë edhe njerëz të rinj për t'i zëvendësuar ata që pensionohen. Besoj se këto tri gjenerata do ta përmbushin

nevojën e Policisë së Kosovës për kuadro të reja", ka thënë Qalaj. Rreth 1 000 pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë arritur moshën 55-vjeçare. Me këtë moshë këta policë do të mund të dilnin në pension po të miratohej Ligji për pensionimin e parakohshëm të Policisë së Kosovës.

Sejdiu: Viti 2019 ishte historik për shëndetësinë



PRISHTINË, 5 JANAR - Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar (ShSKUK), Basri Sejdiu, vitin 2019 e ka vlerësuar si historik për shëndetësinë në vend. Në një intervistë për "Ekonomia Online", Sejdiu ka bërë me dije se realizuan shumë projekte që kontribuan drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për trajtimin e pacientëve.

Dy prej tyre që janë realizuar gjatë vitit 2019 janë trajtimi i infarktut në dy orët e para dhe trajtimi i sulmit në tru. "Viti 2019 mund të shquhet edhe si historik në shëndetësinë kosovare. E them këtë them me plot besim sepse në vitin 2019 për realizohen dy projekte kapitale që janë edhe nacionale siç është sistemi kardiovaskular, trajtimi i infarktut në dy orët e para dhe dy ditët e ardhshme do të fillojë stroke që nënkupton trajtimin e njëjtë edhe të sulmit në tru. Dhe është projekti i dytë nacional dhe këto u realizuan në vitin 2019", ka thënë ai.

Sejdiu, po ashtu, ka treguar se në vitin 2019 janë kryer 3 500 proce-

dura në kardiologji invazive dhe rreth 330 në kardiokirurgji dhe se asnjë pacient nuk ka dalë jashtë për trajtim.

Gjatë vitit që lamë pas Sejdiu thotë se një vëmendje e veçantë i është kushtuar meremetimit dhe modernizimit të klinikave dhe pajisjeve të tyre me infrastrukturë, pajisje mjekësore moderne, por që është punuar shumë edhe për edukimin e stafit mjekësor për përdorimin e mjeteve të avancuara.

Pavarësisht që në vitin 2019 u punua shumë, Sejdiu thotë se mbeten ende projekte që synojnë t'i realizojnë gjatë vitit 2020. Ndër to përmend projektin e neuroshkencës, ndërtimin e kardiokirurgjisë së fëmijëve dhe trajnimin e stafit. Sejdiu thotë se mbesin të përkushtuar që t'i avancojnë shërbimet shëndetësore dhe për këtë kërkon edhe mbështetjen e qeverisë në ardhje. Ai thotë se shëndetësia duhet të mbetet prioritet që duhet të angazhohet e gjithë shoqëria ngaqë nevojat për këto shërbime mbeten të larta.

'Trepça' pret milionat e premtuara p

PRISHTINË, 5 JANAR - Pa investime milionëshe kombinati metalurgjik "Trepça" në Kosovë nuk mund të rimëkëmbet dhe vështirë se do të mund të funksionojë tutje, thonë udhëheqës të kësaj ndërmarrjeje. Planet për kombinatin metalurgjik "Trepça" për vitin 2020 janë të shumta, thonë drejtuesit e ndërmarrjes, por që asnjëri prej tyre nuk mund të realizohet nëse Qeveria e Kosovës, si aksionare e këtij kombinati, nuk i bën investimet e duhura.

Drejtori menaxhues në "Trepçë", Basri Ibrahim, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se gjatë vitit 2019 janë bërë përpjekje të mëdha për ta vënë në funksion më të madh këtë ndërmarrje por, sipas tij, problemet janë të mëdha dhe të grumbulluara ndër vite. "'Trepça' sot ballafaqohet me shumë probleme, duke filluar nga punëtorët e vjetër që vetëm deri në vitin 2022 duhet të pensionohen rreth 250 veta, që do të thotë se ata janë 63-vjeçar dhe kontributi i tyre në minierë është në pikëpyetje të madhe, pasi duhet të ketë një forcë fizike. Kur e kemi parasysh edhe teknologjinë e vjetërsuar, kjo e vështirëson edhe më shumë situatën", thotë Ibrahim. "Trepça" llogaritet si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në ish-Jugosllavi. Në vitet '80 aty punonin mbi 20 mijë punëtorë. Ndërkaq, vitet e fundit ajo e kaloi fazën e mbijetesës dhe aktualisht nuk numëron më shumë se 1 300 punëtorë dhe mosha mesatare e tyre është 58 vjeç.

Sipas të dhënave zyrtare, nga viti 1945 e deri në periudhën para vitit 1990 miniera prodhonte rreth 600 mijë tonë xehe në vit, kurse sot nga aty nxirren jo më shumë se 150 mijë tonë xehe. Ibrahim thotë se gjatë vitit 2019 prodhimi është rritur për 20 për qind, por nuk është arritur ajo që kishin synuar si ndërmarrje. Për vitin 2020 objektivat, thotë ai, janë të shumta, por që duhen investime ose nga Qeveria e Kosovës ose nga



burime të tjera financiare. "Domosdoshmërisht duhet të nxirret Ligji për pensionimin e parakohshëm të minatorëve, pasi nuk kemi mundësi ta rifreskojmë fuqinë punëtore. Të investohet në teknologji, në minierën e Stantërgut në veçanti me të cilën ne do të kemi mundësi të prodhojmë më shumë. Të investohet në flotacion në Stantërg edhe Kishnicë. Synimi ynë është ta aktivizojmë minierën në Hajvali", thotë Ibrahim. Ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë në largim të Kosovës, Valdrin Llluka, pati thënë për "Radion Evropa e Lirë" se viti 2019 do të jetë vit

kur do të fillohet zhvillimi dhe rimëkëmbja e ndërmarrjes "Trepça". Por, përveç miratimit të statutit të "Trepçës" si shoqëri aksionare, ku 80 për qind e aksioneve i bën të qeverisë dhe 20 për qind punëtorëve, kjo ndërmarrje nuk arriti të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe t'i zgjidhë problemet me të cilat përballlet ndërmarrja. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se patën paralajmëruar si OEAK se vetëm ndryshimi i statusit nga një ndërmarrje shoqërore në një ndërmarrje

publike nuk do ta ndihmojë vetvetiu rivitalizimin e "Trepçës". "Ne patëm propozuar që të krijohen mundësi për investime nga sektori privat, në rend të parë investime të huaja në ndërmarrjen 'Trepça' si e vetmja mundësi që ne e kemi parë për futjen e kapitalit të ri në 'Trepçë' dhe ajo që është më e rëndësishmja, futja e teknologjisë dhe njohurive të reja që janë të nevojshme për ndërmarrje të tilla", thotë Zeka. Partia Vetëvendosje, e cila ka dalë fituese nga zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit, ka paraparë një model të ri të qeverisjes së kësaj ndërmarrjeje.

Ringritjen dhe avancimin teknologjik të "Trepçës" e ka paraparë në tri faza që, sipas saj, kalojnë nëpërmjet riparimit të mjeteve ekzistuese, futjes së teknologjisë së re në flotacion dhe xehetari, dhe zhvillimit të metalurgjive e kimisë. Po ashtu, ka paraparë ta shtohet prodhimi dhe kualifikimi i punëtorëve.

PROBLEMET FINANCIARE


Gjatë vitit 2019 ndërmarrja "Trepça" u përball me probleme financiare dhe, si rrjedhojë, minatorët nuk i morën pagat me rregull. Kryetari i Sindikatës

Numri i viktimave nga rrëzimi i aeroplanëve ra për 50 për qind në 2019-n

PRISHTINË, 5 JANAR - Numri i personave të vdekur si pasojë e rrëzimit të aeroplanëve komercialë ka rënë për më shumë se 50 për qind, është thënë në studimin mbi industrinë e aviacionit. Vitin e kaluar 257 persona është raportuar të kenë vdekur, në krahasim me 534 më 2018, ka thënë kompania e aviacionit To70. Kjo shifër është regjistruar pavarësisht rrëzimit të aeroplanit 737 Max të kompanisë Boeing

në Etiopi në muajin mars. Ky numër reflekton një trend të përgjithshëm të uljes së numrit të viktimave, pavarësisht pse udhëtimi ajror është rritur shumë. Më 2019-n kanë ndodhur 86 aksidente që kanë përfshirë aeroplanë komercialë të mëdhenj, duke përfshirë tetë incidente me fatalitet, përkatësisht 257 viktima, ka thënë kompania holandeze e aviacionit, To70. Të 157 personat e vrarë si paso-

jë e rrëzimit të aeroplanit të kompanisë Ethiopian Airlines në muajin mars kanë rritur më së shumti shifrën vjetore. Sipas raportit, një aksident me aeroplan të madh komercial ka ndodhur për çdo 5.58 milionë fluturime të realizuara me sukses. Andaj viti i kaluar është konsideruar "një prej viteve më të sigurta për sigurinë e aviacionit".



ër rimëkëmbje



korupsionit dhe nepotizmit 'Trepça' ka ardhur në këtë gjendje ku nuk po arrihet të sigurohen as pagat e minatorëve. Ka vonesa në pagesën e pagave. Me këtë prodhim nuk arrihen të mbulohen as shpenzimet dhe pagat e minatorëve", pati thënë Sadiku. Gjatë vitit 2019 në Qeverinë e Ramush Haradinaj ishte përfolur privatizimi i pjesshëm i kombinatit metalurgjik "Trepça" si forma më e mirë e rimëkëmbjes së kësaj ndërmarrjeje. Por, një ide e tillë ishte kundërshtuar nga përfaqësuesit e punëtorëve, të cilët janë edhe aksionarë në këtë ndërmarrje.

Profesori universitar në fushën e ekonomisë, Muhamet Sadiku, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" pati thënë se në ekonominë e tregut nuk ekzistojnë mekanizma që qeveria duhet t'i mbajë gjallë ndërmarrjet prandaj, sipas tij, në disa segmente mund të futet kapitali privat. "Të gjitha kompanitë në një shtet duhet t'i nënshtrohen transformimit, respektivisht privatizimit. Për të ardhur aktorët e privatizimit në 'Trepçë' është një punë e vështirë. Kosova duhet të bëhet një shtet miqësor për investime, duhet të fuqizohet shteti ligjor, duhet ditur kush për momentin mund ta qeverisë këtë proces ndërkombëtar. Shpëtimi nuk mund të vijë nga shteti. Shteti duhet ta sigurojë legjislacionin, shteti duhet ta sigurojë shtetin ligjor, duhet të sigurohet barazia e gjithë aktorëve në treg, duhet të rritet transparencja dhe brenda kësaj platforme mund të vijnë investitorët në 'Trepçë'", ka deklaruar Sadiku.

Kombinati metalurgjik "Trepça" gjendet në Komunën e Mitrovicës. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit. Përveç aseteve në Kosovë, dhjetëra prona të këtij kombinati gjenden në republikat e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu fabrika, zyra dhe objekte të tjera. "Trepça" ishte në mesin e ndërmarrjeve më të mëdha në ish-Jugosllavi.

Pritjet e komunitetit të biznesit për vitin 2020

Drejtesit e odave ekonomike në Kosovë dhe njohësit e çështjeve ekonomike kanë thënë se në vitin 2020 presin risi në politikat ekonomike. Sipas tyre, qeveria e re duhet ta nisë hartimin e një strategjie kombëtare të zhvillimit ekonomik, e cila do të ishte udhërrëfyese për të gjitha iniciativat dhe vendimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera

PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pritjet e tij për vitin 2020 janë në reformat ekonomike. "Këtë vit presim risi në politikat ekonomike, nëse fillon punën qeveria që doli nga zgjedhjet e këtij viti. Por, nuk presim shumë ndryshime duke pasur parasysh ngarkesën me temat si dialogu, por edhe presionin social, përfshirë grevat dhe shumë çështje të tjera të hapura dhe të pazgjidhura për shumë vjet", u shpreh ai. Ndërkaq drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se pritjet e komunitetit të biznesit për vitin 2020 dhe qeverinë e re janë të larta. "Qeveria e re duhet ta nisë hartimin e një strategjie kom-

bëtare të zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyese për të gjitha iniciativat dhe vendimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera. Në këtë mënyrë do t'u jepej fund improvizimeve qeverisëse dhe vendimeve ad hoc që e kanë karakterizuar vendin në të kaluarën, sidomos në aspektin e qeverisjes ekonomike", ka deklaruar Zeka.

Drejtori i kompanisë "Meka Halal FOOD", Burim Piraj, ka thënë se në vitin 2020, nëse nuk fillojnë të eliminohen burokracia dhe korrupsioni në institucione dhe nëse nuk lirohet e tërë lënda e parë nga taksa doganore, pa marrë parasysh se kush do ta përpunojë, nuk do të ketë ndryshim. "Jemi dëshmitarë që firmat të cilat punojnë pa fiskalizim dhe në të zezën siç

jemi mësuar ta quajmë ekonominë gri ne kanë arritur kapital shumë të madh, ndërsa firmat legale të cilat i paguajnë taksat dhe detyrimet e shtetit kanë një zhvillim më të ngadalshëm. Sektori tregtar e ka okupuar tregun i cili nga asnjë mekanizëm lokal dhe as i qeverisjes qendrore nuk kontrollohet dhe sot ka shumë supermarkete që janë fare pranë njëritjetrit që në asnjë vend të zhvilluar nuk do t'u jepej leje pune që të mos bëjnë konkurrencë të pajustificuar", ka deklaruar drejtori i kompanisë "Meka Halal FOOD", Burim Piraj. Edhe profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka vlerësuar se marrja e një rruge zhvillimi ekonomik me ritme më të shpejta çfarë i duhet Kosovës mbetet edhe në vitin 2020 çështje me më rëndësi.



Shqiptarët rrisin shpenzimet për turizëm

TIRANË, 5 JANAR - Shqiptarët shpenzuan mbi 1.2 miliard euro për turizëm dhe udhëtime jashtë shtetit në nëntë muajt e parë të vitit që lamë pas. Të dhënat janë bërë publike nga Banka e Shqipërisë në bilancin e fundit të pagesës. Sipas bankës, për periudhën janar shtator të 2019-s shqiptarët shpenzuan plot 1 miliard e 224 milionë euro për udhëtime jashtë Shqipërisë, pjesa dërrmuese e të cilave kanë qenë shpenzime për

turizëm. Të dhënat tregojnë se krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, shpenzimet për turizëm jashtë shtetit janë rritur 10.3 për qind ose 115 milionë euro më shumë. Shifra që shqiptarët shpenzojnë për pushime jashtë është rritur me ritme të larta nga viti në vit. Sipas të dhënave nga konfederata greke e turizmit, vitin e kaluar pushuesit shqiptarë shpenzuan 236 milionë euro vetëm në Greqi.



Ngjarjet në Mal të Zi zhveshin qëllimin e 'minishengenit' serb



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Iniciativa serbe për krijimin e të ashtuquajturit "Minishengenit e Ballkanit Perëndimor" ka qëllim diametralisht të kundërt me parimet e BE-së për krijimin e marrëdhënieve të fqin-

jësisë së mirë të shteteve të kësaj pjese të Evropës ku do të sigurohej lëvizja e lirë e njerëzve, e mallrave, e shërbimeve dhe e kapitalit.

Vetëm disa ditë pas takimit të tretë, të mbajtur në Tiranë, të Aleksandar Vuçiqit, Edi Ramës dhe Zoran Zaevit, ku ishte ftuar edhe presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanović, forcat politike në Mal të Zi, që janë nënë dirijimin e Beogradit njëlloj si Lista Serbe në Kosovë, u ndërmorën aksione të shumta me qëllim të destabilizimit të vendit. Aksionet e orkestruara nga shteti serb nuk u kufizuan

vetëm në territorin e Malit të Zi, por më 2 janar të këtij viti, ata sulmuan Ambasadën e Malit të Zi në Beograd.

Të rikujtojmë se në tetor të vitit 2016, me qëllim parandalimit e anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, Serbia, struktura serbo-ruse u përpoq të organizonin grusht shtet në këtë vend. Në procesin gjyqësor kundër pjesëtarëve që ishin të përfshirë në këtë komplot, Aleksandar Singjeliq pranoi publikisht se oficerët rus Eduard Shishmakov dhe Vladimir Popov i kishin dhënë "katër herë 25 mijë euro dhe dy herë

nga 50 mijë euro" për qëllimet e lartpërmendura.

Eduard Shishmakov dhe Vladimir Popov u dënuan në mungesë me 15, përkatësisht 12 vjet heqje lirie. Ndërkaq 12 pjesëtarët e tjerë të grupit u dënuan me dënime të larta heqje lirie.

Zhvillimet në Mal të Zi ilustronjë në mënyrën më të mirë të mundshme logjikën që mbretëron në Serbi kur bëhet fjalë për shtet e saj fqinje.

Për Serbinë vlerat evropiane të lëvizjes së lirë të njerëzve, të mallrave, të shërbimeve dhe të kapitalit shihen si mundësi për

të realizuar projekte që janë në kundërshtim me vlerat evropiane. Njëpërmjet marrëveshjeve që priten të nënshkruhen në Beograd gjatë muajit janar 2020, Serbia synon ta sigurojë mundësinë e lëvizjes së papenguar të njerëzve të caktuar me misionet politike, veprimtarinë e papenguar të shërbimeve sekrete ruso-serbe, futjes së papenguar të "mallrave" të caktuara dhe "qarkullimit të kapitalit" të "Shishmakovëve", të "Popovëve" dhe të popëve të tjerë për ta destabilizuar tërë rajonin. "Minishengenit" serb ka vetëm këtë qëllim.

Latifi përkujton veprimtarin e çështjes kombëtare Mehmet Morina

Rahovec, 5 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore kushtuar veprimtarit të çështjes kombëtare nga fshati Ratkoc, Mehmet Hajdar Morina, në njëvjetorin e vdekjes së tij.

Përpos Latifit dhe familjarëve të veprimtarit Morina kanë qenë të pranishëm edhe ish-bashkatdhetarët, ushtarët e invalidëve të luftës të UÇK-së. Me këtë rast, Latifi ka thënë se angazhimi i veprimtarit Morina nuk ka qenë i rastësishëm për çlirimin e Kosovës. "Historia nuk mban mend një popull të robëruar që është çliruar pa angazhimin e potencialeve të veta humane, materiale, teknike e financiare, prandaj edhe populli shqiptar nuk bën ndonjë përjashtim. Një nga këta ishte edhe Mehmet Hajdar Morina, i cili, në janarin e 2019-s, më 10 janar, u nda nga ne. Angazhimi personal i bacës

Mehmet nuk është i rastësishëm. Ai dhe vëllezërit e tij kishin dëgjuar shumë rrëfime për dhunën dhe egërsinë e pushtuesve serbë dhe asnjëherë nuk e kishin pranuar si të mirëqenë këtë gjë. Kishin punuar me përkushtim që gjendja e popullit shqiptar të ndryshojë dhe ne ta fitojmë lirinë. Format e kësaj qëndrese ishin të ndryshme dhe nuk pushuan asnjëherë", ka thënë Latifi.

Ai ka shtuar se Mehmet Morina në rrugëtimin për liri nuk ka qenë i vetëm. "Natyrisht se në këtë rrugëtim ata nuk ishin vetëm. Veprimtarët e çështjes kombëtare u bënë bashkë në Perëndim dhe ndihmuan në mbajtjen gjallë të frymës së kundërshtimit. Takimi me vëllezërit Gërvalla, Kadri Zekën dhe veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare në diasporë, ndikoi që baca Mehmet me vëllanë, Isanë, të vihen në radhët e atyre që do të pozicionohen



fuqishëm në rrugën e nderit e të krenarisë. Kur nisi lufta e popullit shqiptar për çlirimin e Kosovës, u bashkuan mendjet dhe zemrat e shqiptarëve anekënd botës dhe u bënë bashkë në një front të përbashkët të luftës. Bashkëvendësit tanë në Zvicër themeluan

shoqatën humanitare 'Ratkoci', duke mbledhur mjete financiare e materiale në shërbim të luftës për liri. Njëri ndër organizatorët e kësaj organizate ishte edhe Mehmet Morina", ka deklaruar Latifi, duke shpalosur detaje nga familja Morina. "Mirënjohja për

baballarët dhe vëllezërit tanë në botën perëndimore do të jetë e lartë. Madje edhe i ati i bacës Mehmet, plaku haxhi Hajdari e nxori pushkën e vjetër dhe ia krisi më 12 maj 1998. Edhe djemtë e bacës Mehmet Kadriu e Dauti ishin ndër të parët që u vunë në rreshtat e parë të çlirimtarëve, si veprimtarë ilegalë e si luftëtarë të UÇK-së. Kjo nënkupton se në atë familje mbizotëronte një frymë lirie, që ishte kultivuar brez pas brezi", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka thënë se u mbetet generatave të reja t'i nderojnë dhe vlerësojnë të gjithë ata që kanë kontribuar për lirinë e Kosovës. "Ndër angazhimet tona mbetet edhe nderimi që ua bëjmë atyre që me mund, djersë e gjak i kontribuan ardhjes së lirisë, respektivisht bacës tonë Mehmet Hajdar Morina dhe të gjithë atyre që ishin në krahun e duhur të historisë", është shprehur Latifi.

Ferizaj me katër hyrje-dalje në autostradën 'Arbën Xhaferi'

FERIZAJ, 5 DHJETOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka bërë me dije se ekonomia ferizajase dhe gjithë qytetarët e kësaj komune kanë arsye të shumta t'u gëzohen investimeve që janë duke ndodhur në territorin e Ferizajt. Në këtë kontekst, kjo komunë kanjoftuar senëkuadërtë investimeve infrastrukturore së fundmi është edhe shtimi i dy kycjeve të reja që lidhin Ferizajin me autostradën "Arbën Xhaferi", duke e çuar në katër numrin e hyrje-daljeve nga kjo komunë për destinacionet që shpie autostrada e

lartcekur.

Për këtë, i pari i Ferizajt, Agim Aliu, ka njoftuar se tashmë Ministria e Infrastrukturës ka nisur procedurat e nevojshme të prokurimit për këto investime. "Është lajm i pritë për një kohë të gjatë, është një përpjekje që është bërë për një kohë të gjatë, që të vihet drejtësia në vend, sepse kycjet që ishin parapare për Ferizajin ishin një lloj padrejtësie. Si rezultat i këmbëngulësisë sonë do të kemi dy kycje të reja, por kërkesa jonë kryesore ka të bëjë me vazhdimin e rrugës 'Driton Islami',

në të njëjtën kohë është realizuar edhe kërkesa që ka të bëjë me fshatin Gërdicë që, po ashtu, paraqet një rëndësi të veçantë për Ferizajin. Duke pasur parasysh gjithë këto kycje, praktikisht Ferizaj shndërrohet në katër pika, duke marrë parasysh edhe kycjen që ka qenë në Bibaj që do t'i shtohet rëndësia, sepse ne kemi planifikuar dhe është në përfundim e sipër procedura e prokurimit: ndërtimi i rrugës me katër korsi nga ura në Bibaj deri te kycja në autostradë që



shton rëndësinë, sikurse edhe ajo kycje me vazhdimësinë e rrugës 'Driton Islami', ka thënë Aliu.

Këto projekte janë realizuar edhe me përpjekjen e deputetëve ferizajas në Kuvendin e Kosovës.

Konflikti me ShBA-në vetëm sa e përkeqëson gjendjen e myslimanëve kudo në botë



Milazim KRASNIQI

Gjendja e myslimanëve në botë në fillim të vitit 2020 është një kombinim i simptomave të një gjendjeje akute në Gjirin Persik e në Afrikë, të një gjendjeje shoku vdekjeprurës në Mianmar e në Kinë, të panikut në Indi, të kolapsit në botën arabe dhe të paqartësive konceptuale në shumicën e shoqërive dhe komuniteteve myslimane. Nga simptomat akute me të cilat dramatikisht filloi viti 2020, është vrasja me dron e gjeneralit iranian Kasem Sulejmanit, në afërsi të aeroportit të Bagdadit. Sikundër është kumtuar zyrtarisht, vrasja e tij është bërë me urdhër të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, i cili, në një deklaratë të mëvonshme, ka thënë se Sulejmani "është dashtë që të eliminohej para shumë vitesh".

Histerizmi që mund ta shkaktojë katastrofën

Reagimet e para zyrtare nga Irani janë të ashpra, hysterike, irracionale. Krahas protestave militante nëpër sheshet e disa qyteteve irانية, janë edhe deklaratat e zyrtarëve të lartë të cilët flasin për "hakmarrje masive" kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në ditët në vijim do të shihet se ç'drejtim do të marrin ngjarjet e armiqësisë ndërmjet Iranit dhe ShBA-së dhe implikimeve që mund të kenë për gjendjen në Irak, në Siri, në Liban, ku ndikimi i Iranit është evident, po edhe në Izrael dhe në Arabinë Saudite, dy shtete që kanë kurs armiqësie ndaj politikave intervencioniste në rajon të Teheranit zyrtar. Eskalimi i konflikteve në këtë rajon mund ta pamundësojë mbarimin e

luftës civile në Siri, mund ta ridestabilizojë Irakun, duke e rikthyer tmerrin e luftës civile e sektare, po mund ta përfshijë në shtjellën e katastrofës edhe Libanin, i cili edhe ashtu tash sa muaj është i përfshirë nga trazira sociale e politike dhe praktikisht është shtet pa qeveri. Ndërsa Izraeli dhe Arabia Saudite mund të përfshihen në konflikt, ose si aleat entuziast të ShBA-së ose si viktima, nëse goditen nga sulmet iraniane. Kësodore, nëse Irani nuk e ndalë hysterinë antiamerikane dhe veçmas nëse vërtet organizon "sulme masive" ndaj objektivave amerikane, mund ta fusë veten dhe rajonin në një konflikt edhe më tragjik. Ndërsa nga konflikti me ShBA-në nuk ka gjasa që të dalë fitues as Irani e as popujt e rajonit. Vuajtjet që janë përjetuar tërë këto decenie e vite nga miliona njerëz në Liban, Iran, Irak dhe në Siri, do të duhej të ishin mësim i mjaftueshëm për të gjithë udhëheqësit në botën arabe dhe iraniane. Nëse vërtet nuk kanë marrë mësim deri tash, ose janë tërësisht të papërgjegjshëm ose janë të verbuar nga fanatizmi irracional. Simptoma e dytë akute e këtij fillimviti ka të bëjë me vendimin e parlamentit të Turqisë që lejon dërgimin e ushtarëve në Libi. Përfshirja e Turqisë në konfliktin civil në Libi mund të ketë pasojë të rënda për vetë Turqinë, sepse pozita e saj gjeopolitike është turbulente. Harxhimi i energjive në Libi, krahas angazhimit enorm në Siri, mund ta bëjë Turqinë fragjile dhe cak të ndonjë tentative tjetër për destabilizimin e saj të brendshëm.

A po shndërrohet Azia në kamp përqendrimi për myslimanët

Gjendja e shokut vdekjeprurës po vazhdon edhe këtë vit për myslimanët rohinja të Mianmarit. Mbi një milion rohinja janë dëbuar nga Mianmari dhe jetojnë në

kushte çnjerëzore nëpër kampe në Bangladesh, ku u janë ekspozuar jo vetëm vuajtjeve, po edhe shfarosjes fizike. Po ashtu, gjendja e ujugurëve myslimanë në Kinë është alarmante. Mbi një milion ujugurë nga dhjetë milionë gjithsej sa jetojnë në Ksingiang janë të futur në kampe përqendrimi, të cilat autoritetet kineze, me eufemizma, i quajnë kampe riedukimi. Projekti i shtetit komunist kinez tenton t'i deislamizojë ujugurët, t'i indoktrinojë me botëvështrim komunist e më vonë t'i inkorporojë në korpusin e shumicës.

Gjithsesi edhe gjendja e 200 milionë myslimanëve në Indi ka njohur përkeqësim në vitet e fundit, nën qeverinë e kryeministrit populist Modi. Eliminimi i autonomisë së Kashmirit, marrja e lokacionit të xhamisë historike në Delhi, ligji i ri diskriminues për azilin politik, që përjashton vetëm myslimanët e shteteve fqinje, kanë përkeqësuar gjendjen e minoritetit më të madh të myslimanëve në botë.

Ku e ka burimin ky përkeqësim tragjik në Azi? Valët në rritje të terrorit antimysliman në Mianmar, në Kinë dhe në Indi, e kanë një pikë të përbashkët: sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në ShBA. Nën pretekstin se po rreshtoheshin në anën e koalicionit kundër terrorizmit ndërkombëtar, Mianmari, Kina, India e bashkë me to edhe Rusia, e shfrytëzuan momentumin dhe i aktivizuan projektet për zhbërjen ose minimalisht për diskriminimin e myslimanëve në ato shtete. Rusia e rifilloi luftën në Çeçeni, Mianmari e filloi gjenocidin kundër rohinjave. Si duket barbaria e autoriteteve birmaneze ka qenë e rekomanduar nga autoritetet kineze, ashtu që nga gjenocidi në Mianmar të maskohej terrori që po kryente Kina kundër ujugurëve. Pra, konkluzioni ynë është se aksionet terroriste, veprimet e çmendura të grupeve si Al Kaida, ose edhe të qeverive të disa shteteve myslimane, siç ishin qeveritë e Sadamit e të Gadafit, thjesht

shfrytëzohen si pretekste për ta rritur presionin, terrorin ose gjenocidin ndaj popujve myslimanë në disa shtete tiranike e islamofobike. Këtë gjë do të duhej ta lexonin qeveritë e shteteve myslimane, që nga Turqia, Irani, Arabia Saudite, Pakistani e të gjitha të tjerat me radhë.

Në këtë kontest të gjendjes tragjike të myslimanëve në Mianmar, në Kinë, në Indi, po edhe në Rusi, është e palogjishme armiqësia irracionale që shpallet nga disa shtete myslimane kundër ShBA-së dhe Perëndimit, kur është e qartë se në ShBA dhe në Evropë, myslimanët janë vetëm pakica më të vogla dhe realisht kanë të drejta njerëzore e fetare më shumë sesa që kanë myslimanët në shumicën e vet shteteve myslimane. Dhe e dyta, në shtete si Kina, India, Rusia e Mianmari myslimanët i janë ekspozuar terrorit, diskriminimit dhe gjenocidit, prandaj nëse ato shtete myslimane e kanë ndonjë kauzë myslimane, ajo do të duhej të koncentrohej në drejtim të Mianmarit, Kinës, Indisë e Rusisë. Nga ana tjetër, qeveritë e shteteve myslimane do të duhej ta kishin të qartë se asnjë krizë e myslimanëve, pra as kriza palestineze, që është në zemër të botës arabe, nuk mund të zgjidhet pa partneritet me ShBA-në dhe me Perëndimin. Realpolitika kësh-tu e jep prospektin.

Ne shqiptarët jetojmë në Evropë, në sferën atlantike

Në gjithë këtë pështjellim tragjik gjeopolitik e gjeokulturor, me të cilin po ballafaqohemi edhe në këtë fillimvit, ne shqiptarët duhet ta mbledhim mendjen: ne jetojmë në Evropë, në sferën atlantike. Rrjedhimisht duhet të sillemi në pajtim me realitetin ku jetojmë e kurrsesi të mos përfshihemi në aventura si ato që çuan jo pak shqiptarë në luftërat në Siri e në Irak, me çka jo vetëm familjeve të tyre, po edhe shtetit tonë e kombit

tonë iu bë një dëm i madh. Kombi ynë duhet të mbetet unik në sintezën e vet kombëtare, si komb evropian, me diversitet e unitet fetar, por plotësisht lojal ndaj kontinentit të vet. Ata që kanë kujtesë historikë e dinë shumë mirë se në dy kthesa tragjike historike, pas Kongresit të Berlinit dhe në Luftën e Parë Ballkanike, Evropa ka planifikuar, në rastin e parë pjesërisht e në të dytin plotësisht zhdukjen e pjesës myslimane të kombit shqiptar, duke e konsideruar si jolojale ndaj civilizimit evropian. Pothuajse e njëjta gjë ka ndodhur edhe me kombin turk, në Luftën e Parë Botërore. Kombi turk dhe shteti turk gjithashtu mbijetoi falë sintezës që arriti ndërmjet Islamit dhe shtetit sekular, më konkretisht falë bashkëjetesës paqësore me civilizimin perëndimor. Ata që nuk kanë kujtesë bëjnë mirë ta rifitojnë. Fjala vjen, duhet ta kenë para sysh se myslimanët në BeH dhe shqiptarët e Kosovës po ashtu si shumicë myslimane mbijetuan vetëm falë intervenimit të NATO-s, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rrjedhimisht, as rohinjat, as ujugurët e as palestinezët nuk mund ta fitojnë lirinë nëse nuk hyjnë në prospektet gjeopolitike të ShBA-së dhe të Perëndimit. Nëse fanatikët eventualisht nuk duan ta kenë kujtesën për këto fakte tokësore, duhet të rezervohen e të mos prodhojnë dëme me miopinë e vet. Minimalisht duhet ta kuptojnë edhe ata se bota po ndryshon në mënyrë të frikshme. Fatkeqësisht, edhe kontinenti ynë po rikthen disa nga simptomat e hershme të islamofobisë, fashizmit dhe të racizmit. Prandaj të gjithë së bashku duhet të dimë si të shmangemi nga goditjet që pritet se mund të na shënjestrojnë në vitet në vijim, nëse nuk jemi mjaftueshëm të mençëm, që të orientohemi saktë në kohë dhe në hapësirë. Kjo nuk ka të bëjë me lirinë e besimit fetar. Ka të bëjë me keqmenaxhimin eventual të saj.

Komuna e Deçanit mban takim me subjektet afariste për çështjen e orarit të punës

DEÇAN, 5 JANAR (ER) - Komuna e Deçanit ka bërë me dije se sot (e hënë) do të mbahet një takim në mes të subjekteve afariste dhe zyrtarëve të kësaj komune.

Në këtë takim, i cili do të nisë në orën 10:00, do të diskutohet për Rregulloren për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Deçan. "Të nderuar përfaqësues të subjekteve

afariste në Komunën e Deçanit, ftoheni në takim pune, më datë 06. 01. 2020, në orën 10:00, në objektin e Komunës së Deçanit, në sallën e takimeve, në katin e tretë. Takimi ka të bëjë

me kërkesat e juaja për orarin e punës sipas Rregullores për caktimin e orarit të punës të subjekteve afariste në Deçan. Ju mirëpresim!", ka njoftuar Komuna e Deçanit.



Trumpi reagon pas kërcënimeve të Iranit

Presidenti Trump tha se Irani në vitet e fundit ka sjellë vetëm probleme dhe le të shërbejë si paralajmërim se për sulmet e Iranit ndaj çdo amerikani apo aseteve amerikane, ne kemi 52 lokacione iraniane, disa në nivel shumë të lartë dhe të rëndësishëm për Iranin dhe kulturën iraniane

UASHINGTON, 5 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, thotë se Uashingtoni ka identifikuar 52 "pozicione iraniane" që do t'i sulmojë "shumë shpejt dhe shumë fuqishëm" nëse Teherani kryen ndonjë sulm në caqet amerikane si shenjë hakmarrje për vrasjen e gjeneralit iranian Qasem Soleimani.

Irani, që ka shpallur tri ditë zie për Soleimanin, u përgjigj ndaj kërcënimit të Trumpit, duke akuzuar ShBA-në se ka shkelur ligjin ndërkombëtar dhe ka kritikuar Trumpin, që ka përmendur se mund t'i sulmojë edhe vendet kulturore të Iranit.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, mbrojti presidentin Trump teksa deklaroi për televizionin ABC se ai nuk kishte dyshim që udhëheqja e "Iranit kupton pikëpamjen e Trumpit dhe ka marrë mesazhin shumë qartë".

Trumpi bëri një sërë reagimesh në "Twitter" lidhur me zotimet e Iranit se do të kundërpërgjigjet për vrasjen e gjeneralit Soleimani. "Irani po flet me shumë guxim për sulmet ndaj disa aseteve të ShBA-së në shenjë hakmarrjeje për shkak se ne vramë liderin e tij të terrorizmit, i cili sapo kishte vrarë një amerikan dhe plagosur disa të tjerë, për të mos përmendur edhe njerëzit e tjerë që ai kishte vrarë gjatë jetës së tij, kohët e fundit qindra protestues iranianë", shkroi Trumpi në llogarinë e vet në "Twitter".

Trumpi shtoi se Qasem Soleimani, që u vra nga një sulm me dron i

kryer nga ShBA-ja, teksa po udhëtonte në Irak më 3 janar, kishte sulmuar Ambasadën Amerikane në Bagdad dhe po "përgatiste sulme të tjera në lokacione të ndryshme". "Irani vitet e fundit ka sjellë vetëm probleme. Le të shërbejë si paralajmërim se për sulmet e Iranit ndaj çdo amerikani apo aseteve amerikane, ne kemi 52 lokacione iraniane (që përfaqësojnë 52 amerikanë të marrë peng nga Irani shumë vite më parë), disa në nivel shumë të lartë dhe të rëndësishëm për Iranin dhe kulturën iraniane", tha Trumpi.

Trumpi shkroi se në "këto caqe edhe vetë Irani do të kryejë sulme shumë të shpejta dhe të fuqishme. ShBA-ja nuk do më kërcënime".

Referenca e Trumpit për pengjet amerikane, i referohet marrjes nën kontroll të Ambasadës Amerikane në Teheran më 1979 nga revolucionarët iranianë, ku 52 amerikanë u mbajtën peng për 444 ditë.

Ndërkaq, përmendja nga presidenti amerikan për lokacionet kulturore ngriti mjaft shqetësime në mesin e kritikëve dhe zyrtarëve të Iranit. "Ata që maskohen si diplomatë dhe të gjithë ata që paturpësisht identifikojnë caqet kulturore dhe civile iraniane nuk duhet as që të brengosen që t'i lexojnë ligjet", shkroi në "Twitter", ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif.

Irani është zotuar se do të hakmerret, por deri më tani nuk ka marrë ndonjë veprim ushtarak. Në sulmin e 3 janarit, përveç liderit të Forcave elite iraniane Quds, Soleimanit, është vrarë



edhe Abu Mahdi aw-Muhandis, zëvendëskomandanti i milicisë në Irak, Hashd Shaabi, milici kjo që mbështetet nga Irani.

Komentet e Trumpit u pasuan nga komente të ngjashme nga një komandant i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit, i cili përmendi 35 caqe amerikane, të cilat Irani mund t'i godasë në kundërpërgjigje.

Agjencia iraniane e lajmeve, "Tasnim", ka cituar gjeneralin Gholamali Abuhamez të ketë thënë se Teherani do t'i ndëshkojë amerikanët kudo që mundet dhe ka sugjeruar se mund të kryejë sulme ndaj anijeve në Gjirin Persik.

Lideri suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, gjithashtu ka kërcënuar se do të ndërmarë veprime hakmarrëse ndaj "kriminelëve" që kanë vrarë gjeneralin Soleimani, përderisa presidenti iranian, Hassan Rohani, deklaroi se vrasja e gjeneralit iranian do ta bëjë Teheranin më të vendosur në rezistencën e tij kundër ShBA-së.

Ndërkaq, këshilltari i Rohanit, Hesameddin Ashena, ka shkruar në "Twitter" se Irani "ka zero

probleme me popullin amerikan" dhe theksoi se edhe në të kaluarën ka arritur që të arrijë marrëveshje me administratën amerikane. "Problemi ynë i vetëm është Trumpi. Nëse ndodh lufta, ai do ta mbajë përgjegjësinë e plotë", ka shkruar ai.

Vendimi i Trumpit për ta vrarë Soleimanin është mirëpritur nga mbështetësit e tij republikanë, por ka hasur në kritika nga demokratët, të cilët thonë se një gjë e tillë mund që ShBA-në ta fusë në luftë me Iranin.

Forcat Quds, që udhëhiqte Soleimani, nga ShBA-ja konsiderohet organizatë e huaj terroriste.

Në shumë qytete amerikane protestuesit kanë kundërshtuar vrasjen e gjeneralit Soleimani. "Pa drejtësi, pa paqe, ShBA-ja jashtë Lindjes së Mesme", kanë brohoritur protestuesit në qendër të Nju Jorkut. Disa nga protestuesit kanë mbajtur në duar pano me mbishkrime "Ndaloni bombardimet në Irak" dhe "Jo luftë apo sanksione ndaj Iranit".

Rreth 200 protestues para Shtëpisë së Bardhë kanë bro-

horitur "jo luftë në Iran" dhe tubime të ngjashme janë mbajtur edhe në Çikago, Filadelfi, San Francisko dhe vende të tjera në ShBA.

Shumë prej aleatëve tradicionalë të ShBA-së gjithashtu kanë shprehur shqetësimin e tyre se vrasja e gjeneralit iranian mund të nxisë një konflikt të armatosur në Lindje të Mesme.

Ndërkaq, në Irak, koalicioni i udhëhequr nga ShBA-ja, më 5 janar tha se kanë ndodhur dy sulme me raketa në afërsi të bazave irakiane ku janë të vendosur trupat e koalicionit, por nuk është raportuar se ka pasur të plagosur në mesin e forcave. Megjithatë, koalicioni ka raportuar se nga këto sulme janë plagosur civilë irakianë. "Në natën e 4 janarit dy raketa kanë goditur në afërsi të bazave irakiane ku janë të vendosur trupat e koalicionit në Bagdad dhe Balad", tha zëdhënësi i koalicionit, koloneli Myles B. Caggins III.

Uashingtoni e fajëson Iranin se ka orkestruar sulmet ndaj ShBA-së, përfshirë edhe sulmin ndaj Ambasadës Amerikane në Bagdad më 31 dhjetor.

Parlamenti irakian u kërkoi trupave amerikane të largohen



BAGDAD, 5 JANAR - Parlamenti i Irakut miratoi një rezolutë nëpërmjet së cilës u kërkoi trupave të huaja ushtarake të largohen nga vendi. Ky është një vendim që pason pas sulmit ajror amerikan gjatë të cilit u vra gjenerali iranian Qasem Soleimani. "Qeveria irakiane merr përsipër ta anulojë kërkesën e saj për ndihmë nga koalicioni ndërkombëtar që lufton grupin ekstremist të Shtetit Islamik për shkak të

përfundimit të operacioneve ushtarake në Irak dhe arrijtes së fitores", thuhej në rezolutën e miratuar të dielën.

Qeveria e kryeministrit Adil Abdul-Mahdi duhet "të punojë për t'i dhënë fund pranisë të të gjitha trupave të huaja në tokën irakiane dhe t'i ndalojë ata të përdorin tokën, hapësirën ajrore ose ujë për çdo arsye", thuhet në rezolutë.

Ndërkohë koalicioni i udhëhequr nga ShBA-ja që po lufton

Shtetin Islamik në Irak e Siri njoftoi të dielën se tani për tani ka ndalur shumicën e operacioneve kundër militantëve dhe është përqendruar në mbrojtjen e forcave dhe bazave të koalicionit, në mesin e tensioneve në rritje me Iranin. Një zëdhënësi theksoi se koalicioni i udhëhequr nga ShBA-ja do të vazhdojë të kryejë disa operacione dhe se do të veprojë për vetëmbrojtje kundër militantëve.



vipa
GËZUAR

www.pestova-ks.com

PESTOVA

The advertisement features a festive theme with green snowflake ornaments hanging from the top. The word 'GËZUAR' is written in a large, stylized, red, cursive font. Below it, there is a pile of golden, ridged potato chips. The background is white with scattered red stars and dots.



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

The advertisement shows a round metal can of 'PASHTETË PULE' (chicken meat) from MEKA HALAL FOOD. The can is decorated with a photo of the meat product, garnished with a green herb and a slice of red pepper. The background is a vibrant orange with white brushstroke patterns.

Poezitë e Lulzim Tafës edhe në gjuhën sllovene

Këto ditë shtëpia e njohur botuese sllovene "Amonit" ka botuar një përmbledhje me poezi të zgjedhura të poetit nga Kosova, Lulzim Tafa, me titull "Ne kliči me v nedeljo" ("Të dielave mos më thirr"), i cili libër është përkthyer dhe botuar në disa gjuhë të botës. Libri ka zgjuar interesim te lexuesit e poezisë në Slloveni dhe është shpërndarë nga rrjeti më i madh i distribuimit të librit në Slloveni.

Parathënien e këtij libri e ka shkruar studiuesi i njohur slloven, profesori dhe shkrimtari i shquar Jo-e Brenčiči i cili në parathënien e tij ka shkruar: "Tafa është një poet që dramën e tij jetësore përpiket ta përmbledhë, portretizojë dhe pastaj ta unifikojë me pamjen e botës përreth nesh. Mendimet e tij janë të qarta dhe koncize. Në mënyrë precize ai e bën të mundur vendosjen e një komunikimi të plotë dhe pothuajse të përsosur me lexuesit.

Që në fillim, kur bëhet fjalë për poezinë e këtij poeti, është e domosdoshme për t'i përcaktuar arrijtet estetike dhe veçantitë e lirikës së tij.

Edhe pse përmbledhja me poezi "Të dielave mos më thirr" është e ndërtuar nga një larmi njësisish të shkurtra konceptuale-tematike, megjithatë ato arrijnë në një tërësi unike mendore dhe

artistike, duke përfaqësuar poetin në çdo shkëlqim në gjithë opusin e tij krijues.

Kështu, në poezinë e tij me titull "Poetët" lexojmë vargjet e bukura e mbresëlënëse /kur zemërohen zotat/ lindin poetet /në të parën shenjë të jetës /protestojnë /për të vazhduar /shpërndajnë afishe kundër vetvetes /nëpër qytet/dhe për ta përmbyllur /fëmija i tepërt i secilës nënë / bëhet poet/.

Pra, poetët janë disa njerëz të veçantë, me shqisa të mprehta që vërejnë gjithçka, vërej nëse shteti shpejt do t'u vërë /taksa për ëndrrat/ për buzëqeshjet /por që megjithatë ngushëllohen me vargjet se /sa mirë që nuk i takson dhembjet/shteti human/ (poezia Taksat).

Poeti nuk shkruan asnjë varg të vetëm kot, ai nuk vdes as kur i /vdes muza/, (poezia Epitaf) e as /kur i bie pika e vargjeve në zemër/ (Poezia Lament). Poeti, gjithashtu, është një kritik mendjempërthë kur thotë çka po na duhen gjithë këta heronj dhe vëren se heronjtë tani prodhohen me bollëk dhe në /kushte të dobëta higjienike / (poezia Laboratori).

Tafa në poezi ironizon edhe me të drejtat e njeriut kur thotë se, /këtu nuk shkelen të drejtat e njeriut/këtu shkelen vetëm kokat / (poezia Reportazh), kurse për të drejtat e kafshëve



thotë se /respektohen plotësisht /në secilën kasaphane / (poezia Ligji për kafshët).

Libri është i mbushur përplot me poezi edhe të dashurisë /Të dielën mos më thirr më /mund të mos zgjohem /përjetë të rri në gjumin e vdekjes /mos i harro çastet e ngrira /veç të

dielës /zgjidhe ditën tënde/për ty kur të vdes /pas shtatë bjeshkësh do ta gjej emrin /dhe për ta përmbyllur me /ah/ pse nuk vjen ditëve të tjera/, kështu që na bënë të konstatojmë se në jetë vetëm momentet e këndshme numërohen.

Prandaj, të gjithë atyre që janë të

interesuar dhe duan të njohin fjalë të bukura poetike me të cilat fjalë të bukura janë ndërtuar këto poezi dhe ky libër, unë ua rekomandoj leximin e këtyre poezive, pasi tani është e mundshme, ngaqë e kemi edhe në gjuhën sllovene, ka shkruar Joe Brenčič.

Një vizion poetik për kurthin e çastit në ekzistencën njerëzore



Dr. Arben HOXHA

Përmbledhja më e re me poezi e poetit tashmë të njohur Pal Ndrecaj, me titull "Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë", është një vepër e cila na futë në "galaktikën" e qartësisë së vetëdijes për mospërputhjen që ekziston midis dëshirave, aspiratave e idealeve tona dhe botës në të cilën ekzistojmë. "Nëpër


galaktikën..." poetike të Pal Ndrecaj lexuesi mund ta shijojë dramën e dispropozicionit etik që ekziston midis dëshirave e idealeve të njeriut në botë dhe refuzimit që bota ua bënë atyre idealeve e dëshirave.

Si të bëhen aspiratat tona të pranueshme për botën?

Të hysh "Nëpër galaktikën..." poetike të Pal Ndrecaj do të thotë ta shijosh qartësisht fatumin e çarjes së thellë që ekziston mes ekzistencës njerëzore dhe botës, si gjendje në të cilën ajo ekzistencë bëhet e dukshme. Të hysh "Nëpër galaktikën..." poetike të Pal Ndrecaj do të thotë ta përjetosh pamundësinë e realizimit të

absolutes dhe drithërimën rrënuese që shkakton qartësia e vetëdijes për kurthin që çasti ia ngrit ekzistencës njerëzore.

Vëllimi poetik i Pal Ndrecaj "Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë" është shprehje e një vizion poetik mbi këtë kurth të çastit, i cili, jo që e mohon fuqinë vepruese të "iluzionit" brenda gjendjes njerëzore, por, përkundrazi, përmes tij i bën ftesë ëndrrave, dëshirave e idealeve, të cilat e fuqizojnë pozicionin e të mirës, të bukurës të vërtetës, si shfaqje të absolutes në përmbushjen e detyrës për ruajtjen e dinjitetit të vazhdimësisë së ekzistencës njerëzore në botë.



Bibliotekës Komunale 'Hivzi Sylejmani' iu shtuan edhe 1 426 tituj të ndryshëm

Prishtinë, 5 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se Bibliotekës Komunale "Hivzi Sylejmani" iu shtuan edhe 1 426

tituj të ndryshëm të cilat prej kohe ishin të kërkuara nga lexuesit e këtij institucioni. "Në listën e shfrytëzuesve të rregullt, përpos qytetarëve, ka edhe një numër të

madh studentësh, kërkesat e të cilëve janë mirëpritur nga menaxhmenti i Bibliotekës "Hivzi Sylejmani". Prej literaturës angleze dhe asaj franceze e deri

te përrallat për më të vegjëlit, tirazhi për Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" po vazhdon të rritet çdo ditë e më shumë", ka bërë me dije Ahmeti.



Një libër i shkrimtarit italian Giovanni Catelli argumenton se Camus është vrarë nga KGB



Gjashtëdhjetë vjet pasi fituesi i çmimit Nobel, Albert Camus, vdiq në një aksident automobilistik në moshën 46 vjeçare, një libër i ri argumenton se ai është vrarë nga spiunët e KGB-së, për shkak të retorikës së tij kundër-sovjetike.

Autori italian, Giovanni Catelli, fillimisht e nxori në dritë këtë teori në vitin 2011, duke shkruar në gazetën *Corriere della Sera* se kishte zbuluar shënime në ditarin e poetit dhe përkthyesit çek, Jan Zábrana, që sugjeronte se vdekja e Camus-së nuk kishte qenë aksidentale. Tashmë Catelli e trajton më gjerësisht kërkimin e tij në një libër të titulluar *Vdekja e Camus-së*.

Camus vdiq më 4 janar 1960 kur botuesi i tij, Michel Gallimard, humbi kontrollin e makinës dhe u përplas me një pemë. Autori vdiq menjëherë, ndërsa Gallimard-i disa ditë më pas. Tre vite më parë, autori i romaneve *I huaj* dhe *Murtaja*, kishte fituar çmimin Nobel për "hedhjen e dritës mbi problemet e ndërjegjës njerëzore në kohën tonë".

"Aksidenti dukej se ishte shkakuar nga një plasje e gomës ose nga thyerja e boshtit; ekspertët u habitën që ndodhi në një rrugë të drejtë e të gjatë, me gjerësi prej nëntë metrash dhe

me pak lëvizje në atë orar", shkroi Herbert Lottman në biografinë e tij të vitit 1978 për shkrimtarin.

Catelli beson se arsyen e shpjegon një paragraf në ditarin e Zábrana-s: nga fundi i verës së vitit 1980, poeti shkroi se "një njeri i ditur e me njohje të mira" i kishte thënë se duhej fajësuar KGB-ja. "Ata kishin vendosur një pajisje te goma, e cila në fund e shpoi kur automjeti po udhëtonte me shpejtësi të lartë".

"Duket se atyre iu deshën tre vite për ta ekzekutuar urdhrin", shkruhet në ditarin e Zábrana-s. "Në fund ata arritën ta bëjnë në një mënyrë të tillë që deri më sot, të gjithë mendojnë se Camus vdiq nga një aksident i zakonshëm automobilistik. Ky burrë refuzoi të më tregonte burimin e tij, por tha se ishte plotësisht i besueshëm".

Që prej vjeshtës së vitit 1956, Camus kishte mbajtur publikisht anën e revoltës hungareze dhe i kritikonte jashtë mase veprimet e sovjetikëve. Ai gjithashtu vlerësonte e mbështeste publikisht shkrimtarin rus, Boris Pasternak, i cili konsiderohej kundër-sovjetik.

Catelli e ka studiuar për vite me radhë vërtetësinë e shënimeve të Zábrana-s. Në librin e tij, ai interviston vejtashëm e Zábrana-

s, Marie-në, heton infiltrimin e KGB-së në Francë dhe përfshin dëshmi të cilët persona të tretë i kanë thënë avokatit francez, Jacques Vergès. Catelli ishte kontaktuar nga Giuliano Spazzali, një avokat italian, pas botimit të librit në italisht. Spazzali kujton një bisedë që pati me të ndjerin Vergès për vdekjen e Camus-së.

"Vergès u shpreh se aksidenti ishte planifikuar. Është opinionimi se Vergès kishte më shumë prova nga ç'u kujdes të ndante me mua. Por u përmbajta e nuk bëra më pyetje", Spazzali i tha Catelli-t. Maturia është sjellja më e mirë kur diskutohet papritur një temë delikate. Nuk hetova më tej, e megjithatë e mbaj mend se si Vergès ishte i sigurt se aksidenti ishte planifikuar nga një seksion i KGB-së, me mbështetjen e inteligjencës franceze".

Catelli argumenton se e folura haptazi e Camus-së po ndërhynte në marrëdhëniet midis Francës dhe Bashkimit Sovjetik, dhe se "karakterit i mirënjohur i Camus-së ... spikaste në sytë e francezëve si një kujtesë ndaj imperializmit mizor të Bashkimit Sovjetik. Si qeveria franceze, ashtu dhe ajo sovjetike, do të përfitonin jashtë mase nëse do ta shuanin këtë kujtesë të pakëndshme ...

Nuk u krye asnjë hetim i mirëfilltë".

Familja e Catelli-t tha se teoria e tij nuk u mbështet nga vajza e Camus-së, Catherine, e cila ia ndaloi shtëpisë botuese Gallimard që të citonte veprën e babait të saj. Sidoqoftë, ky libër është botuar në Francë, Argentinë e Itali, dhe ka marrë mbështetjen e shkrimtarit amerikan, Paul Auster, i cili e quajti bindës argumentin e Catelli-t.

"Një konkluzion i tmerrshëm, por pasi e asimilova provën që na dha Catelli, bëhet e vështirë të mos biesh dakord me të. Ndaj dosja "aksident automobilistik" tani duhet vendosur në një sirtar tjetër me mbishkrimin "vrasje politike", e kështu e heshtën Albert Camus-në kur ishte 46 vjeç", shkruan Auster në një parathënie.

Shpresoj se studiuesit nuk do ta marrin të mirëqenë opinionin e vjetër se ishte një aksident i thjeshtë", u shpreh Catelli, i cili po bisedon me botuesit anglezë për një përkthim në anglisht. "Mendoj se duhet ta bëjmë në kujtim të Albert Camus-së".

Pedagogia e letërsisë franceze në Universitetin Cambridge, Alison Finch, nuk është bindur. "Mbështetësit e teorisë së vrasjes përfshijnë një shkrimtar kreativ e regjisor filmash (Paul

Auster); një shkrimtar e përkthyes çek, familja e të cilit është persekutuar nga regjimi komunist dhe që kishte arsye të fortë ta urrente komunizmin (Jan Zábrana); avokatin tejet polemik, Jacques Vergès, i cili, për të qenë i sigurt, mbrojti luftëtarët algerianë të pavarësisë që u torturuan nga francezët, por që u bë famëkeq pasi mbrojti të pambrojtshmen. Sigurisht, ligji këtë duhet të bëjë, por në përgjithësi ai do të shihej si një rebel në vend të një kritiku të besueshëm".

Finch gjithashtu vuri në pikëpyetje sugjerimet për përfshirjen e francezëve. "Kjo do të nënkuptonte se vrasja ishte aprovuar në nivelet më të larta, me shumë gjasa nga De Gaulle. Kjo për mua është e paarsyeshme. De Gaulle, një shkrimtar i arrirë, kishte respekt të madh për intelektualët francezë, përfshi dhe ata me të cilët kishte bindje të kundërta", tha ajo.

Libri *Vdekja e Camus-së* mbyllet me Catelli-n që shpreson se do të paraqiten më shumë prova, "përpara se valët e kohës të mbulojnë gjurmët e brishta të asaj që ka ndodhur".

Marrë nga "The Guardian"
Exlibris /Përktheu David
Hudhri

E rrallë

Writen 16 luanë për mjekësi popullore

16 luanë janë varë mizorisht për t'u marrë fytyrat e për t'ua shitur si përbërës për mjekësi popullore. Gjahtarët e paligjshëm kanë hyrë në një zonë të rrethuar, në Afrikën e Jugut, ku kanë varë edhe disa luanesha të cilat duhej të lindnin këlyshë pas pak ditësh. Mendohet se luanëve u është dhënë mish pule i helmuar për t'i paralizuar dhe nga gjithë kopeja ka mbijetuar vetëm një këlysh. Luanët po mbaheshin në një qendër



për kafshë, në provincën veri-perëndimore të Afrikës së Jugut.

FOTO E DITES



Gara e akullt në Shenyang në provincën verilindore të Kinës në Liaoning. /AFP/

E jashtëzakonshme

Monedha fatsjellëse 'shkatërron' kinezin, 17 mijë dollarë gjobë për bllokimin e avionit

Një 28-vjeçar u gjobit me 17 mijë dollarë pasi hodhi një monedhë fati në njërin prej motorëve të avionit përpara nisjes. Fluturimi u anulua nga kompania pasi gjeti monedhën afër motorit, duke kërkuar kështu edhe një inspektim më të



hollësishëm. 28-vjeçari me origjinë kineze pranoi se ishte ai që e hodhi monedhën për fat të mirë pasi ishte hera e parë që fluturonte me avion. Ai doli përpara gjykatës në korrik, por çështja e tij u bë publike më 3 janar.

BARSOLETA E DITËS



Veterineri: Gruaja juaj është këtu me macen dhe kërkon t'i bëjë eutanzion (shkaktim i vdekjes në mënyrë mjekësore). Pajtoheni ju me këtë?
Burri: Po, patjetër. Kurse macen lëshojeni, se di të shkojë vetë në shtëpi.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon and Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Ta hapësh veten në një mundësi të


re romantike do të thotë se po hap veten drejt intensitetit emocional dhe trazirave, prandaj kini kujdes.



DEMI

Zemra është një vend i bukur, i

ngrohtë, ku mbani kujtime të veçanta dhe ide nostalgjike, por nuk është një hapësirë e pafundme.



BINJAKËT

Ju jeni dëshmi e gjallë që një person

nuk ka pse të jetë një gjimnast olimpiq për të qenë jashtëzakonisht i aftë në ekuilibër!



GAFORRJA

Kur hasni një person nga e kaluara juaj

sot, mbështetuni në kujtesën tuaj të mirë për t'ju ndihmuar të gjeni një fillim të shkëlqyer të bisedave.



LUANI

Nëse po mendoni të bëni blerje të reja ditën e

sotme, mund të mos jetë zgjidhja më e mirë e mundshme. Blerja e gjërave për të bërë veten të ndiheni më mirë mund të sigurojë lehtësim të përkohshëm.



IRGJËRESHA

Duke shkuar disa muaj apo vite

mbrapa në marrëdhënien që keni, mund të bëni një kthesë të madhe sot falë një zbulimi.



PESHORJA

Ndikimet në jetën tuaj sot janë natyrisht

mashkullore në natyrë. Kjo mund të nënkuptojë se burrat do të jenë aktorët kryesorë në dramën e sotme.



AKREPI

Është shumë e lehtë për të qenë

i drejtpërdrejtë, por sot lloji më i dobishëm i komunikimit për ju do të jetë përgjimi.



SHIGJETARI

Nuk do të jetë aq e mërzitshme sa mendoni

dhe do të mësoni se si të parandaloni më shumë stres dhe presion në jetën tuaj.



BRICJAPI

Shkrimi i një letre dashurie, ose akoma

më mirë një këngë dashurie, do t'u tregojë atyre se nuk jeni si të gjithë të tjerët.



UJORI

Për fat të mirë, vëmendja juaj ndaj

detajeve është shumë e madhe tani. Një përmbledhje duhet t'i zbulojë të gjitha gabimet që mund të gjenden atje.



PESHQIT

Kjo do t'ju ndihmojë në përforcimin e

asaj që jeni akorduar dhe t'i zgjeroni horizontet tuaja. Në kohën tuaj të lirë, rrii ulur dhe shikoni botën të kalojë.

Camila Morrone ishte adhuruese e Justin Bieberit para se të lidhej me Leonadro Di Caprion



Modeluesja e njohur Camila Morrone është në lidhje të dashurisë me aktorin Leonardo Di Caprio. Morrone në një intervistë për "W Magazine's Best Performances" ka thënë se dikur ajo

ishte një adhuruese e madhe e këngëtarit Justin Bieber. "Kam shkuar në shumë audicione dhe në prapskenë ulesha dhe dëgjoja këngët e tij. Kam qenë një Belieber e madhe", ka thënë Morrone.

Nicole Kidman dhe Keith Urban dhurojnë 500 mijë dollarë për Australinë



Aktorja e famshme Nicole Kidman dhe partneri i saj, këngëtarit australian Keith Urban, u janë bashkuar të famshmëve të tjerë për t'u dalë në ndihmë njerëzve në Australi pas zjarreve masive që kanë vazhduar.

"Mbështetja, mendimet dhe lutjet e familjes sonë janë me të gjithë të prekurit nga zjarret në Australi. Ne po dhurojmë 500,000 dollarë për Shërbimet e Zjarrit Rural që të gjithë po bëjnë dhe po japin aq shumë tani", kanë shkruar çifti në "Instagram".



Kylie Jenner, femra më e ndjekur në 'Instagram'

E vogla e Kardashianeve i ka kaluar motrat e mëdha për nga ndjekësit në "Instagram", pasi Kylie Jenner momentalisht është femra më e ndjekur. Kylie ka kaluar Kimin e cila numëron 155

milionë ndjekës, ndërsa vetë ka 156 milionë. Pos që janë pjesë e përditshme e shtypit rozë, motrat Kardashian kanë edhe linjat e tyre të veshjeve dhe kozmetikës.

Brad Pitti kujton puthjen e parë të dashurisë: Isha i ngazëllyer

Aktori i njohur Brad Pitt në një intervistë për "W Magazine" ka kujtuar momentin e puthjes së parë. Pitti ka pohuar se ishte shumë i ngazëllyer nga ky moment që i kishte ndodhur. "Vajza që e kam puthur ishte Lisa. Puthja jonë ndodhi në garazhin e shtëpisë së saj. Unë menjëherë u largova vrapova dhe shkova në shtëpinë time, ajo mbeti jashtë në rrugë", ka treguar Pitti.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Transferime të fuqishme nga klubet që ndjekin titullin

Transferimi kryesor i realizuar të dielën është Sebino Plaku. Gjilani beson se përvoja e madhe e 34-vjeçarit nga Shqipëria do t'i ndihmojë që ta ndjekë titullin e kampionit. Ndërsa ditë më parë Llapi e transferoi Arbër Prekazin, kurse Drita Kastriot Rexhën. Në ditët e ardhshme priten edhe transferime të tjera të fuqishme nga këto klube, kurse Prishtina ende vazhdon të jetë e heshtur në këtë afat kalimtar



Daku, i cili në sezonin vjeshtor ishte pjesë e Kukësit në Shqipëri. Duarkryq nuk kanë qëndruar as Gjilani dhe Drita që e mbyllën vitin 2019 në mesin e tri skuadrave të para në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Dritës në fundvit arriti t'i rikthejë në radhët e veta dy sulmuesit e njohur Astrit Fazliu dhe Kastriot Rexhën, me synim që ta rikthejë edhe trofeun e më të mirit, derisa nga ky klub janë regjistruar edhe largimet e para: Lucas Cardoso dhe Gilberto Fortunato. Ndërsa Qëndrim Dautaj, për shkak të minutave të paktë për t'u paraqitur, vendosi ta braktisë skuadrën e Gjilanit, por drejtuesit e klubit të dielën bënë goditjen e parë të madhe,

duke e transferuar Sebino Plaku. Sulmuesi shqiptar e ka braktisur skuadrën e Llapit dhe ka nënshkruar kontratë me Gjilanin deri në fund të këtij kampionati. "Gjilani dhe futbollisti nga Shqipëria, Sebino Plaku, kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi, nga ku do ta mbajë futbollistin e lartcekur si pjesë e skuadrës së Gjilanit deri në fund të këtij edicioni garues", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Plaku sezonin e fundit luajti për Llapin,

sezonin pranveror. Feronikeli ka bërë disa transferime, e kryesori është Ilir Berisha, por ka larguar lojtarë me përvojë të madhe si Astrit Fazliu, Arbër Prekazi, Kastriot Rexha, Albutrint Morina, Lulzim Doshllaku, Haxhi Neziraj dhe Milos Krkotiq.

Lëviz edhe Drenica, pozitën e trajnerit ia beson Gani Sejdiu

Klubi i Drenicës pati një sezon të mirë, duke përfunduar në pozitën e gjashtë me 24 pikë. Ky klub bëri ndryshime në kryesi dhe në shtab teknik. Tahir Lushtaku vendosi të largohet dhe pozitën e tij klubi kuqezoi ia besoi trajnerit Gani Sejdiu. Ky i fundit njihet si trajner i sukseseve, pasi e shpalli Trepçën kampione, sikurse edhe Feronikelin. Në këtë klub si përforcime janë ardhur Egzon Fazliu dhe Endrit Shala, kurse janë larguar dy të huazuarit nga Feronikeli, Keita Balde dhe Nicholas Andrews. Ndërsa Atthe Grajqevci iu bashkua Llapit për sezonin pranveror.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 JANAR - Klubet që janë duke e ndjekur titullin e kampionit, Ballkani, Drita dhe Gjilani, janë mjaft aktivë në afatin kalimtar të futbollistëve, derisa Prishtina ende është duke qëndruar në heshtje. Lëvizje kanë bërë edhe skuadrat e tjera elitare, përfshirë Feronikelin.

Ballkani i Ismet Munishit, që është kampion vjeshtor, e ka transferuar mbrojtësin me përvojë të madhe, Arbër Prekazin dhe Roni Gashin, por priten edhe transferime të tjera në këtë afat kalimtar. Futbollisti i radhës që gazeta ka mësuar se do të "aterojë" në Suharekë është Mirind

Daku, i cili në sezonin vjeshtor ishte pjesë e Kukësit në Shqipëri. Duarkryq nuk kanë qëndruar as Gjilani dhe Drita që e mbyllën vitin 2019 në mesin e tri skuadrave të para në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Dritës në fundvit arriti t'i rikthejë në radhët e veta dy sulmuesit e njohur Astrit Fazliu dhe Kastriot Rexhën, me synim që ta rikthejë edhe trofeun e më të mirit, derisa nga ky klub janë regjistruar edhe largimet e para: Lucas Cardoso dhe Gilberto Fortunato. Ndërsa Qëndrim Dautaj, për shkak të minutave të paktë për t'u paraqitur, vendosi ta braktisë skuadrën e Gjilanit, por drejtuesit e klubit të dielën bënë goditjen e parë të madhe,

Federata e Pingpongut hap afatin e regjistrimit të klubeve

PRISHTINË, 5 JANAR - Federata e Pingpongut e Kosovës ka njoftuar të gjithë të interesuarit se nga data 1 janar deri më 31 janar 2020 është i hapur afati për regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve në FPPK për sezonin 2020. Këtë lajm e ka bërë me dije sekretari gjeneral i FPPK-së, Fadil Luta. "Bordi i FPPK-së ka marrë vendim që afati për regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve në Federatën e Pingpongut të Kosovës të jetë nga data 1 janar deri më 31 janar 2020", u shpreh Luta. Po ashtu, ai njoftoi për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për regjistrimin e klubeve në FPPK.



"Për t'u regjistruar një klub në Federatën e Pingpongut të Kosovës duhet të plotësohet formulari i regjistrimit i cili mund të shkarkohet në sajtin e FPPK-së www.fppk.com, si dhe t'i bashkëngjiten dokumentet e kërkuara në formular. Ne si feder-

atë jemi në dispozicion për t'ju ndihmuar dhe sqaruar për çdo paqartësi rreth regjistrimit", ka thënë ai. Më tutje, ai njoftoi se Komisioni për regjistrim në kuadër të FPPK-së do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet më 1 shkurt 2020. "Komisioni për regjistrim të klubeve do të takohet më 1 shkurt 2020, duke filluar nga ora 10:00, në Federatën e Pingpongut dhe do ta shqyrtojë dokumentacionin e të gjithë aplikuesve për vitin 2020, andaj i ftojme të gjithë të interesuarit të fillojnë sa më parë me mbledhjen e dokumenteve për regjistrim të klubeve", u shpreh ai.

Berisha: Faleminderit Prishtinë për përkrahjen, Pejë për mikpritjen

PEJË, 5 JANAR - Basketbollisti më i mirë në Kosovë, Dardan Berisha, do ta fillojë aventurën e re me skuadrën e Pejës. Ai ka nënshkruar kontratë për një vit e gjysmë me klubin e vendlindjes. "Të dashur fansa dhe adhurues të basketbollit kosovar, nga sot unë do të jem lojtar në klubin e vendlindjes sime, KB Peja. Ju falënderoj nga zemra për mirëpritjen dhe dashurinë që më keni dhuruar! Prishtinë, faleminderit për përkrahjen e vazhdueshme! Falënderoj Klubin e Prishtinës dhe tifozët e saj 'Plisat' për këto



vite gjatë të cilave shënuam histori në gara evropiane! Suksese të gjithë klubeve të basketbollit në Kosovë! Qofshim shembulli më i mirë për të gjithë vendet në rajon. Fansa, ju faleminderit që gjithmonë jeni lojtari ynë i 6-të!", ka shkruar Berisha.

Dy futbollistët nga Gjilani do të provohen në FC Winterthur

GJILAN, 5 JANAR - Dy futbollistët, vëllezër nga Gjilani, Olti dhe Odi Mehmeti, do të provohen në skuadrën e Winterthurit në Zvicër. Lajmin e ka bërë me dije trajneri Genc Sermaxhaj nëpërmjet një postimi në

"Facebook". Olti Mehmeti është pjesë e FC Drita me moshën U19, kurse Odi Mehmeti është pjesë e U17. "Shkathësitë e tyre i njoh mjaft mirë sepse me të dy kemi kaluar sezone me rezultate të suksesshme, ndërsa

tani po stërvitemi në aspektin individual që të jenë sa më të gatshëm për synimet e reja. Uroj që Olti dhe Odi ta shfaqin gjithë potencialin e tyre gjatë qëndrimit tremujor në FC Winterthur", ka thënë Sermaxhaj. "Gjithashtu, nga

FC Drita do të vazhdojnë të zhvillohen edhe shumë talentë të tjerë, për të cilët do të kujdesem që t'i përgatis sa më mirë për sfidat e reja, më pastaj të krenohemi me sukseset e tyre", ka shtuar Sermaxhaj.



Istogu në vend të Shoshit emëron Salagiqin

ISTOG, 5 JANAR - KF Istogu nuk ka humbur kohë dhe e ka gjetur trajnerin e ri. Bëhet fjalë për Kemal Salagiq, i cili e zëvendëson Valdet Shoshin që zyrtarisht u largua nga skuadra e Istogut

të shtunën. "Stafit të trajnerëve të Istogut i është bashkangjitur trajneri i mirënjohur istogas, Kemal Salagiq. Stafit të trajnerëve do të përbëhet nga Kemal Salagiq, Hysni Kabashi dhe

Mehdi Arifaj. Salagiq ishte pjesë e Istogut në sezonin 2007-2008, kur Istogu ishte shpallur kampion në Ligën e Parë", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre. Gjithashtu, klubi që

bën gara në Ligën e Parë ka njoftuar të gjithë futbollistët se sot (e hënë) nga ora 13:00 do të mbahet mbledhja e parë e futbollistëve, stafit të trajnerëve dhe kryesisë së klubit.



Fortesa Orana: Synoj pjesëmarrjen në Olimpiadë

PRISHTINË, 5 JANAR - Lojërat Olimpikë janë ngjarja më e rëndësishme sportive në botë. Aty ku çdo sportist garon për një medalje, e që është kurorëzimi i një pune 4-vjeçare. Vitin e ardhshëm këto lojëra pritet të organizohen në Tokyo. Aty ku edhe shumë sportistë nga Kosova synojnë të jenë të pranishëm dhe të luftojnë për medalje. Një ndër sportistët që është duke synuar të marrë pjesë në këto lojëra është edhe karateistja Fortesa Orana, e cila është duke punuar me përkushtim të madh që ta arrijë normën dhe ta përfaqësojë sportin e karatesë në këtë ngjarje. Orana vitin 2019 e ka cilësuar të suksesshëm për të dhe sportin e karatesë, kështu duke veçuar disa gara në të cilat ka marrë pjesë duke arritur rezultate të favorshme. "Viti 2019 ka qenë një vit i veçantë. Garën që më ka veçuar dhe që ka qenë një sukses mjaft i madh për mua, ka qenë Kampionati Evropian që është mbajtur në Madrid të Spanjës. Aty jam renditur në pozitën e pestë në Evropë dhe fati nuk deshi që të stolisem me medalje, edhe pse kam qenë shumë afër. Ka qenë një garë mjaft e fortë, një ëndërr e imja që të jem pjesë si medaliste, por referimi nuk ka qenë shumë i drejtë për mua, duke cekur që me garuesen spanjolle isha duke fituar 2:0, e në fund



më diskualifikuan me vërejtje pa ndonjë arsye", ka thënë Orana për "KosovaPress".

Orana si dhe sportistët e tjerë hasin në shumë probleme, më së shumti në aspektin financiar, duke mos arritur të marrin pjesë në shumë gara ndërkombëtare pikërisht për shkak të këtij problemi. Si pasojë e financave ajo ka humbur pjesëmarrjen në tri premierë liga. "Po hasim në shumë probleme, duke pasur parasysh që tri premierëliga nuk i kemi ndjekur për shkak të financave. As Federata nuk ka mundur të na bëjë zgjidhje. Në Madrid kam shkruar me mjete të miat që jam munduar t'i gjej në Komunën e Gjilanit. Nuk duhet të ketë këso lloj probleme një

sportist që synon medaljen e artë ose një sportist që synon olimpiadën. Mendoj se duhet t'i kthejnë sytë kah ne, nga sporti i karatesë, sepse kemi talente", ka shtuar ajo. Ndërsa sa i përket vitin 2020, Orana ka deklaruar: "Synimet e mia për vitin 2020 janë shumë të mëdha, si krejt sportistët, por edhe në sportin e karatesë. Është Evropiani. Është Olimpiada. Është Botërori. Jam duke u munduar shumë që të jem pjesë e Olimpiadës. Jam afër dhe jam potenciali më i madh për të qenë e kualifikuar në Olimpiadë. Kualifikimet më të rëndësishme janë në Paris dhe, nëse e arrij vendin e parë ose të dytë, shkoj direkt në Olimpiadë".

Lakersat dominojnë në Konferencën e Perëndimit, triumfojnë Houstoni dhe Bostoni

LOS ANGELES, 5 JANAR - Lakersat vazhdojnë të dominojnë në Konferencën e Perëndimit. Kjo skuadër e mposhti me rezultat 123-113 New Orleansin, takim i dominuar nga kalifornianët. Ndashje magjike e Anthony Davisit, që realizoi 46 pikë e 13 rebounde, mbështetur nga Greeni me 25 pikë dhe Jamesi me 17 pikë e 15 asistime. Fiton edhe Houstoni ndaj Philadelphias (118-108), sfidë ku mysafirët e nisën mirë ndeshjen (Simmons me 29 pikë, 13 rebounde e 11 asistime). Në pjesën e dytë vjen përmbysja e Houstonit, ku u dalluan Hardeni me 44 pikë, 11 rebounde e 11 asistime, mbështetur edhe nga Capela me 30 pikë e 14 rebounde, raporton "Telesport". Skuadra e Bostonit triumfoi në sekondat e fundit me rezultat 109-106 ndaj Atlantias, takim ku skuadra e Celticsit trefoloi shumë në fund. Të pestë titullarët e Bostonit realizuan mbi 10 pikë (Browni 24 pikë e 10 rebounde), duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Youngut. Orlando,



falë 25 pikëve të Terrence Rossit, mundi 105-85 Miamin, ndërsa Portlandi triumfoi me rezultat 122-103 në fushën e Washingtonit (Lillard 35 pikë). Skuadra e Phoenixit mposhti 120-112 New Yorkun, ndeshje ku u dallua Bookerit me 38 pikë.

REZULTATET

Boston - Atlanta	109-106
Orlando - Miami	105-85
Washington - Portland	103-122
Houston - Philadelphia	118-108
Phoenix - New York	120-112
Lakers - New Orleans	123-113

SHKURT

Publikohet lista e Shqipërisë për ndeshjen e yjeve

Shqipëria e yjeve do të përballet kundër Turqisë, Greqisë dhe Italisë. Ndeshjet do të zhvillohen në "Air Albania", ndërsa paratë e fituara nga shitja e biletave do të shkojnë për të prekurit nga tërmeti. Së fundmi është zbuluar edhe lista e kuqezinjve. Atje do të kemi shumë legjenda që janë kthyer për ta mbrojtur fanellën e Shqipërisë, ku mund të veçohet si një rast i veçantë edhe drejtori sportiv i Kukësit, Nderim Nexhipi.

Lista e plotë: Foto Strakosha, Lorik Cana, Edvin Murati, Alban Bushi, Igli Tare, Altin Lala, Besnik Hasi, Altin Rrakli, Erjon Bogdani, Arjan Beqaj, Artim Shaqiri (Maqedoni e Veriut), Klodian Duro, Ervin Bulku, Armend Dallku, Nevil Dede, Debatik Curri, Hamdi Salih, Redi Jupi, Nderim Nexhipi (Maqedoni e Veriut) dhe Adrian Aliaj. Trajner: Ilir Shulku.

Rangersi nuk llogarit në Grezdën, huazimi duket i pashmangshëm

Eros Grezda po kalon momentet e tij të fundit në radhët e Glasgow Rangersit. Pas problemeve që ka pasur me trajnerin Steven Gerard që sollën edhe degdisjen e tij nga skuadra e parë tek ajo e të rinjve, futbollisti shqiptar do të largohet nga gjiganti skocez. Drejtuesit e Rangersit po mendojnë ta huazojnë te një tjetër skuadër në mënyrë që edhe Grezda ta fitojë formën e tij më të mirë. Lajmi raportohet nga mediat skoceze edhe pse emrat e klubeve të interesuara për shërbimet e Grezdës nuk bëhen ende të ditura.

Pioli: Ibra është një dhuratë e madhe nga Milani

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, ka dhënë disa komente lidhur me transferimin më të ri në skuadër, Zlatan Ibrahimoviç. Sulmuesi suedez ka nënshkruar kontratë për gjashtë muaj me skuadrën 'Rosoneri', për t'i ndihmuar ata për pjesën e mbetur të sezonit. Pioli e sheh transferimin e Ibras si një dhuratë të madhe për të, pasi beson se mund ta shfrytëzojë për mrekulli. "Ibrahimoviç është lojtar i mirë, ai ka karizmën dhe ai nuk është ndalur kurrë së përmirësuar ose ngritur nivelin e lojës. Zlatan do të sjellë entuziazëm dhe përvojë, si dhe dëshirë të madhe" ka thënë Pioli për 'Gazzetta dello Sport'.

Lampardi e dëshiron Zahan

Chelsea vazhdon të kërkojë një sulmues për pjesën e dytë të kampionatit. E ardhmja e Oliver Giroud te "blutë e Londrës" vazhdon të jetë në pikëpyetje dhe për këtë trajneri Frank Lampard ka hedhur sytë nga Wilfried Zaha, që aktivizohet me Crystal Palace. Drejtuesit e klubit nga "Stamford Bridge", për ta bindur lojtarin të transferohet te Chelsea, i kanë ofruar një kontratë prej 200 mijë paundësh në javë, ndërsa edhe vetë Zaha ka kërkuar largimin nga Crystal Palace.

Tifozët e Barcelonës kërkojnë largimin e Valverdes

Postimi i dytë më i përdorur në Katalonjë është "Valverde Out", pas barazimit kundër Espanjolit në derbin që u luajt të shtunën në mbrëmje dhe nuk la aspak të kënaqur tifozët e Barcelonës. Sërisht një tjetër barazim dhe një paraqitje jo mirë për Barcelonën, bënë që tifozët të revoltohen me skuadrën e tyre. Pa dyshim se fajtori, sipas tyre, për formën jo të mirë, është Ernesto Valverde dhe tifozët në rrjetet sociale kërkojnë largimin e tij nga timoni i skuadrës. Në 10 ndeshjet e fundit jashtë fushe për këtë sezon, katalanasit kanë vetëm 15 pikë dhe kjo ka bërë që Valverde të jetë në një pozitë të vështirë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 30.12.2019

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019, nxjerr vendim sipas të cilit:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë
shpall
K O N K U R S
për emërimin e personelit akademik të rregullt në UHZ

I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:

FAKULTETI JURIDIK

Mësimdhënës

1. Një mësimdhënës për lëndët: E Drejta e Procedurës Civile, E Drejta e Procedurës Civile Pjesa e Posaçme, Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Kriminalistika, Kriminaliteti Kompjuterik, Viktimologjia, Klinika Juridike Penale;
3. Një mësimdhënës për lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Administrative, E Drejta Administrative - Pjesa e Posaçme.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Emërimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet të kenë së paku gradën doktor të shkencave (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve) në fushën përkatëse, si dhe të plotësojnë kushtet tjera siç parashihen në nenin 171, 172 dhe 173, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.


II. KUSHTET PËR APLIKIM:

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjet e diplomave përkatëse të noterizuar, certifikatën e lindjes, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, dëshmi të organeve kompetente që nuk është nën hetime si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; ndërsa, ata të cilët janë të punësuar në Institucione të Arsimit të Lartë (Universitete) duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për me shumë se një pozitë duhet të sjellin kopje fizike për aq pozita sa aplikojnë.
3. Kandidatët të cilët dëshmojnë se njohin gjuhën angleze, frënge apo gjermane kanë përparësi si aplikues.
4. Kandidatët që kanë mbaruar studimet bachelor, master ose doktoratës jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht kopjen e vendimit për nostrifikimin të noterizuar të diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.
5. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 14.01.2020.
6. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:
<http://www.unhz.eu>



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Protokol. Br.

Peç , 30.12.2019

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, UA br. 07/2017 o regulisanju konkursne procedure u javnom sektoru, član 26. Zakona o visokom obrazovanju na Kosovu, br. 04 / L-037, člana 169, 170, 171, 172, 173, 174, statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, br. 04-V-622, uredbе o ličnom dohotku Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. Pro. 1944/16, dt. 05.10.2016, Pravilnika o postupku procjene za izbor, reizbor i napredovanje redovnog akademskog osoblja na Univerzitetu " Haxhi Zeka " u Peć-i, br. 754, dt. 01.04.2019, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, na sjednici održanoj dana 27.12.2019, donio je odluku prema kojoj:

UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" Peć
objavljuje
K O N K U R S
za izbor redovnog akademskog osoblja na UHZ

I. Konkurs se objavljuje na sledećim pozicijama:

PRAVNI FAKULTET

Nastavnik za predmete ;

1. Jedan nastavnik za predmete: Zakon o parničnom postupku, O parničnom postupku posebni dio, Arbitraža i posredovanje;
2. Jedan nastavnik za predmete: Kriminalistiku, Kompjuterski kriminal, Viktimologija, Klinika za krivično pravo;
3. Jedan nastavnik za predmete: Uvod u pravo, Upravno pravo, Upravno pravo - Posebni dio;

II. OPŠTI USLOVI

1. Izbor akademskog osoblja vrši se u skladu sa Zakonom br. 04 / L-037 o visokom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, Pravilnika za Procedure vrednovanja o reizboru i unapređivanje akademskog osoblja Pro. Br. 754 dt. 01.04.2019 na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći.
2. Kandidati koji apliciraju za nastavnika mora imati najmanje diplomu doktora nauka (Ekvivalent - Fakulteta likovnih umjetnosti) u odgovarajućoj oblasti i da ispunjavaju druge uslove kao što je navedeno u članu 171,172 i 173, Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći.

III. USLOVI ZA APLICIRANJE

1. Kandidati koji se prijavljuju za nastavnika moraju dostaviti sljedeće dokumente: zahtjev sa biografijom, ovjerene kopije relevantnih diploma, izvod rođenih, dokaz o naučnim i stručnim publikacijama, dokaz od nadležnih organa da nije pod istragom, kao i druge dodatne specifične informacije, koje su važne za one koji se prijavljuju; dok oni koji su zaposleni na Fakultetu treba da dostave odluku o posljednjem izboru.
2. Kandidati koji se prijavljuju za više od jedne pozicije moraju dostaviti fizički toliko primjerak za svaku poziciju za koju aplicira.
3. Kandidati koji dokažu da znaju engleski, francuski ili njemački jezik imaju prednost kao aplikant.
4. Kandidati koji imaju doktorat, magisterij ili koji su završili master u inostranstvu moraju također priložiti dokaze za provjeru relevantnih diploma iz MONT-a, naprotiv odluku o nostrifikaciji određene diplome, u suprotno, dosje od podnosioca će se smatrati nepotpunim.
5. Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj web- stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 14.01.2020.
6. Ispunjene aplikacije zajedno sa kopijama potrebnih dokaza na osnovu konkursa , trebaju se poslati u elektronskoj formi na e-mail: apliko.online@unhz.eu a onda i predati u kancelariji protokola u Rektoratu od 09:00-15:00 h. Aplikacije poslane posle roka kao i one nekompletne neće se razmatrati.

Konkurs možete pronaći objavljen i na web stranici na adresi:
<http://www.unhz.eu>



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.776/19

GJYKATA THEMLORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Gentiana Merovci-Alija me vendbanim në Gjermani, të cilën e përfaqëson me autorizim av.Rexhep Kaçaniku nga Mitrovica, kundër të paditurit Blendi Merovci me adresë të panjohur në Gjermani, lidhur me zgjidhje të martesës, jashtë seance, me datën 26.12.2019, mori këtë:

AKTVENDIM

I. CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm av. Lirim Perçuku nga Vushtrria, për t'i ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrat për të paditurin Blendi Merovci, deri sa të paraqitet i njëjti në gjykatë apo përfaqësuesi i tij/saj me prokurë.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet në gjykatë personalisht, të caktoj të autorizuarin e tij apo deri në momentin kur organi kujdestarisë-QPS në Vushtrri ti caktoj kujdestarin.


III. Ky aktvendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes të kësaj gjykate, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, paditësit dhe organit të kujdestarisë.

IV. Seanca e ardhshme do të mbahet me datën 21.01.2020, nga ora 09:00 minuta, në këtë gjykatë, zvara nr.23. Ky komunikim u shërben në vend të thirrjeve të rregullta.

GJYKATA THEMLORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.776/19, datë 26.12.2019



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 30.12.2019

**NJOFTIM**

I. Anullohet pjesërisht konkursi për emërimin e stafit të rregullt akademik ref. nr. 3029/19, të dt. 21.11.2019, konkretisht pozitat si më poshtë:

- Një mësimdhënës për grup lëndësh Civile;
- Një mësimdhënës për grup lëndësh Administrative - Kushtetuese;
- Një mësimdhënës për grup lëndësh Penale;

II. Në bazë të vendimit të Senatit ref. nr. 3562/19, të dt. 27.12.2019, për anulimin e pjesëshëm të konkursit ref. nr. 3029/19, të dt. 21.11.2019, dhe shpalljen e konkursit konformë propozimit të Këshillit të Fakultetit Juridik ref. nr. 3029/19, të dt. 21.11.2019, njoftohen të gjithë së interesuarit se konkursi do të publikohet në web të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe mjetet e informimit më dt. 31.12.2019.

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën: 15.01.2020 e Mërkurë prej orës: 11.00 ne fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës, Senat Neziri e mbron publikisht punimin e Doktoratës me titull, "Ndikimi i Shqipes në të folmen e minoriteteve në rajonin e Prizrenit".

**Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"
Fakulteti Ekonomik, Prishtinë**

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 15.01.2020 (të mërkurën) prej orës 11:00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidati MSc. Arben Sahiti i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me temën: "Vlerësimi i faktorëve me ndikim në performancën financiare të kompanitë me investime të huaja direkte në Kosovë", me mentor Prof. Dr. Skender Ahmeti, para komisionit profesional, në përbërje prej:
Prof. Asoc. Dr. Hysen Ismajli - kryetar i komisionit,
Prof. Dr. Rahmije Mustafa Topxhiu - anëtare e komisionit,
Prof. Asoc. Dr. Brikend Aziri - anëtar i jashtëm i komisionit (Universiteti i Tetovës).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Armend (Behram) Kajtazi, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT (elektr.tek.informat.) "Anton Çetta" Skenderaj

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza",

banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

Duke u bazuar ne ligjin Nr. 03/L 214 për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania D.P.H "Caj Bahce Nargile" Prizren, ne bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis për prodhimin e produkteve të nargiles dhe duhanit ne Prizren.

Njoftohen publiku i interesuar se me datën: 27.01.2020 ne orën 13:00 ne lokalet e kompanisë "Caj Bahce Nargile" rruga "William Woker" mbrapa fakultetit UB-se ne Prizren do te organizohet debat publik nga kompania D.P.H "Caj Bahce Nargile" Prizren, ne bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Debati publik do te organizohet per Raportin e Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis per prodhimin e produkteve të nargiles dhe duhanit ne Prizren.

Pjesëmarrja juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

GENERAL PROCUREMENT NOTICE (GPN) # 6

Government of Republic of Kosovo
Millennium Foundation of Kosovo (MFK)

Published date: December 27, 2019

The Government of the Kosovo has received grant funding of UD\$49 million (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to enable the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Threshold agreement, and it intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for contracts for goods, works and services.

The procurement program for the next period will include the following:

Procurements for period November 2019 - November 2020
Procurement of Goods In the Reliable Energy Landscape Project including:
DHM - Metering system supply & installing
Procurement of Works In the Reliable Energy Landscape Project including:
Household Efficiency Retrofits (HER) Intervention Package - EE materials and products
AER -Apartment Building Efficiency Retrofits Sub-activity Works
Procurement of Services In the Reliable Energy Landscape Project, Transparent Governance Project and Administration sector, including:
Public Access to Judicial Information Activity Case Management Information System (CMIS)
Consultancy (Stakeholders workshops for Judicial Dig Data Challenge)
Consultancy (Open Data Challenge – Energy Data Preparation)
Communication and Outreach for Judicial Data Challenge
Event Management for CMIS workshops and promotional activities
Consultants - Jury for Open Data Challenge
Dig Data Air Quality Awards Ceremony & Promotion and Events for the Energy Dig Data
Consultancy (Open Data Training of Gov't/CSO's/Private Sector) for Energy Dig Data
Consultancy (Open Data Challenge – Energy Data Preparation)
Translation and Interpretation services
Project Support Specialist – Energy Efficiency (Individual Consultant)
Data Quality Review for Transparent Governance

Contracts for goods, works and services financed under the program will be implemented according to the principles, rules and procedures set out in the MCC Program Procurement Guidelines, which can be found at the MFK's website.

The procurement is open to all bidders from eligible source countries as defined in the MCC Program Procurement Guidelines.

Specific procurement notices for contracts to be tendered under the competitive bidding procedures and for consultant contracts will be announced, as they become available, on the MFK website, United Nations Development Business (UNDB): <http://www.devbusiness.com/>, Development Gateway Market (dgMarket): <http://www.dgmarket.com/>, in local newspapers, and other media outlets as appropriate.

Interested eligible contractors and consultants who wish to be included on the mailing list to receive a notice of advertisements should subscribe on the MFK website under the link: <https://millenniumkosovo.org/subscribe/> and select under the list *Procurement*, or those requiring additional information, should contact:

Procurement manager:	Arton Çitaku – MFK Procurement Manager
c/o:	Millennium Foundation of Kosovo
Address:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Telephone:	+ 383 38 752 110
Email:	procurement@millenniumkosovo.org

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.T. "Rimida" Llapnasellë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e objektit hotelierik B+S+P+3 në vendin e quajtur "Kod Izvor" në Vërbeshticë në komuna e Shtërpçës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 24.01.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Pine" rruga për Brezovicë, do të organizohet debat publik nga kompania N.T. "Rimida" Llapnasellë, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e objektit hotelierik B+S+P+3 në vendin e quajtur "Kod Izvor" në Vërbeshticë në komuna e Shtërpçës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Alba - RJ" Sh.p.k Krushë e Vogël, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimi i gurit gëlqeror në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.01.2020 në ora 11:30 në hapësirat e restorant "Ura e Fshejt" në Xërxë komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Alba - RJ" Sh.p.k Krushë e Vogël, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimi i gurit gëlqeror në Rahovec.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK, modifikon formularët tatimor PD dhe CD

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat Personale (PD) dhe Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (CD), janë duke u modifikuar, andaj deri më 31 janar 2020, nuk mundësohet dorëzimi i këtyre formularëve.

Modifikimi/ndryshimi në formularët PD dhe CD, do të bëhet kryesisht për:

- Zbritjet për sponsorizim në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë;
- Shumën obligative për pagesë;
- Mundësinë e parashtrimit të Kërkesës për Rimbursim;
- Mundësinë e përdorimit të pagesave tepër në këstet paradhënie për vitin vijues, si dhe në obligimet tjera të pashlyera;
- Shtimi i rubrikave, si: Llogaria bankare, Numri i llogarisë bankare dhe Mbajtësi i llogarisë.

Përmes formularit CD, tatimpaguesit të cilët kanë spozorizuar në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë duke plotësuar kushtet e përcaktuara me Ligjin për sponsorizimet, do të kenë mundësinë e zbritjes së atyre sponsorizimeve nga shuma obligative e tatimit për pagesë.


Gjithashtu, përmes këtyre formularëve (PD dhe CD), tatimpaguesit do të kenë mundësinë që të kërkojnë Rimbursim për pagesat tepër gjatë vitit apo nëse dëshirojnë mund të zgjedhin që pagesat tepër gjatë vitit t'i lënë parapagim me qëllim të mbulimit të obligimeve tjera të pashlyera ndaj ATK-së apo në pagesa paradhënie për vitin vijues.

Pra, me rastin e dorëzimit të formularit të deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit, nëse nga tatimpaguesi plotësohet rubrika "Kërkesë për Rimbursim", ATK do të pranojë kërkesën e tillë pa pasur nevojë që tatimpaguesi të dorëzojë edhe ndonjë kërkesë tjetër të veçantë për Rimbursim, mirëpo, në formular domosdoshmërisht duhet të jenë të plotësuara edhe rubrikat "Llogaria bankare", "Numri i llogarisë bankare" dhe "Mbajtësi i llogarisë".

Ndërsa në rastin kur tatimpaguesi ka paguar më tepër gjatë vitit përmes kësteve paradhënie dhe nuk plotëson rubrikën "Kërkesë për Rimbursim", ATK do të konsideroj se pagesat tepër do të përdoren për këste paradhënie për vitin vijues apo për mbulimin e obligimeve tjera të pashlyera ndaj ATK-së, që tatimpaguesi mund t'i ketë në atë moment apo edhe që mund t'i lindin në të ardhmen.

Publikimi i formularëve të modifikuar do të bëhet më 31.01.2020 dhe të gjithë tatimpaguesit nga kjo datë e tutje mund të deklarojnë dhe të paguajnë përmes këtyre formularëve.

Administrata Tatimore e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.743/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditesit Valon Hasani nga fshati Stroc, Vushtrri, të cilin e përfaqëson av.Arsim Krasniqi nga Prishtina, kundër të paditues Majlinda Islami me adresë të panjohur në qytetin e Shkupit, të Maqedonisë Veriore, lidhur me shkurorezim, jashtë seance, me datën 18.12.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm av.Irfan Zushi nga Vushtrria, Regjioni i Mitrovicës për t'i ushtruar të gjitha të drejta dhe detyrat për të padituesen Majlinda Islami, deri sa të përfundon kjo çështje juridike.

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditueses Majlinda Islami, deri në momentin kur e paditura të paraqitet në gjykatë personalisht, të autorizoj të autorizuarin e saj apo deri në momentin kur organi kujdestarisë-QPS në Vushtrri ti caktoj kujdestarin.

Ky aktvendim do të publikohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes të kësaj gjykate, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditueses, paditëseve dhe organit të kujdestarisë.

A r s y c t i m

Paditësi Valon Hasani, të cilin e përfaqëson av.Arsim Krasniqi me datën 07.11.2019 pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi për zgjidhjen e martesës kundër të paditueses Majlinda Islami, me adresë të pa njohur.

Në bazë të propozimit të përfaqësuesit të paditësit av.Arsim Krasniqi nga Prishtina në seancën përparore të datës 18.12.2019, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitivin e nenit 79 par 3 pika a) të LPK-së

pasi që vendqëndrimi i të paditueses ishte i pa njohur saktësisht kurse e njëjta nuk kishte përfaqësues me prokurë.

Mbi këto arsye, gjykata ka vendosur që të paditueses ti caktoj përfaqësuesin e përkohshëm nga radhët e avokateve pasi që e njëjta me vendbanim dhe vendqëndrim të pa njohur sakt në Republikën e Maqedonisë Veriore, ndërsa OAK e ka bere përzgjedhjen e avokatit Irfan Zushi nga Vushtrria si përfaqësues i përkohshëm për të padituesen.

Nga sa u tha më lart e duke u bazuar në vështrim të nenit 79, 81, 82 dhe 83 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.743/19, datë: 18.12.2019

G J Y Q T A R I
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Regjistrimi i Mallrave në Stoque

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se në bazë të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguesit duhet të regjistrojnë mallrat në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimi i tillë duhet të jetë i gatshëm më së largu deri me datën 10 Janar të vitit 2020.

Çdo tatimpagues, pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet të kryejnë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik.

Regjistrimi i tillë, duhet të përfundohet më, apo para datës 10 Janar të vitit vijues dhe të jetë në dispozicion për inspektim me kërkesën e Administratës Tatimore të Kosovës.

Shënimet e regjistrimit të mallrave, përfshijnë treguesit vijues:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Vlera

Regjistrimi i mallrave duhet të mbahet me çmimin e kostos.

Administrata Tatimore e Kosovës, i rikujton të gjithë tatimpaguesit, të cilët nuk respektojnë afatin e paraparë për të regjistruar mallrat në stoqe, se do të jenë objekt i masave ndëshkuese të parapara me Legjislacionin Tatimor të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ra Eximp" SH.P.K. Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për grumbullimin dhe riciklimin e akumulatorëve në Shupkocv komuna e Mitrovicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.01.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Verona" rruga "Shemsi Ahmeti", pran kompleksit industrial të Trepçës në Mitrovicë do të organizohet debat publik nga Kompania "Ra Eximp" SH.P.K. Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.


Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për grumbullimin dhe riciklimin e akumulatorëve në Shupkocv komuna e Mitrovicës..

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqët tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përftuar nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.